



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXIV / Nr. 02 / Shkurt 2025



Ramazani

PO NA THËRRET



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al

Viti XXXIV i botimit

Nr. 02 (501)

Shkurt, 2025


ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al





editorial

04 Qëndrueshmëria në istigfar-kërkimfalje
Mehmet Disha

në fokus

06 Dobitë shpirtërore, morale dhe sociale të agjërimit
Dorian Demetja

lajme / aktivitete

08 01-Nënshkruhet marrëveshja e haxhit për vitin 2025
në Xhide të Arabisë Saudite
02-Nunci Apostolik viziton KMSH-në në përfundim të misionit të tij diplomatik në Shqipëri
03-Vizitë Pune në Myftininë Kamëz
04-Firmoset marrëveshja për projektin e shportës së Ramazanit për vitin 2025

refleksione

12 Njohja e njeriut ndaj vetes së tij
Ragib el-Isfahani

çështje fetare

16 Muaji i madhërisëm i Ramazanit përmes pyetjeve I
Këshilli i çështjeve fetare - insi.al

familja

18 Parimet e Edukimit Profetik: "Lehtësoni, mos vështirësoni"
Armand Asllani

horizonti i besimit

20 Ballafaqimi me sfidat mendore dhe emocionale
H. Bujar Spahiu

22 Intervistë rreth dobive shëndetësore të agjërimit
me mjekun Enver Bami / Redaksia

24 Muaji Shaban dhe Nata e Beraetit
Elton Karaj

28 Ramazani po na thërreth
Leonard Çela

jetë sahabësh

30 Ndjeshmëria e Sahabeve në të shprehur
Tauland Bica

bota shpirtërore


32 "Zoti juaj ka thënë: "M'u lutni Mua, se do t'ju përgjigjem!"
Lejla Dervishi

hapësirë femërore

36 Gjendet burimi i Zemzemit
Orhan Sezgin

këndi i poezisë

38 Gazel
Mevlana



Qëndrueshmëria në istigfar-kërkimfalje



Është në natyrën e njeriut që të jetë gabimtar dhe i dobët në aspektin e përgjithshëm. Kjo gjë nuk është një veti e domosdoshme dhe e pandashme e karakterit të tij, por është një fazë që i përket rrugëtimit dhe kohës që merr metodologjia e ndjekjes së hapave në mënyrë që të përshkohet distanca nga fara te lisi, nga dobësia në forcë, nga lëkundja në qëndrueshmëri. Kur themi në "natyrën e njeriut" kemi parasysh hadithet dhe ajetet që na e shpjegojnë krijimin e njeriut nëpërmjet spektrit të fuqisë së Krijuesit i Cili fsheh urtësi dhe fuqi të jashtëzakonshme në një pikë të vogël.

Duke qenë se kjo anë gabimtare, e tundueshme, pra kjo anë e nefsit që prirët nga e keqja, është pjesë e jona, është me patjetër një mënyrë që nxjerr në pah disa Cilësi të Zotit që pasqyrohen në shembëllim të njeriut. Gabimtarit i bën karshillëk Falja, nevojtarit Mëshira dhe bujaria, të sëmurit, Shërimi e kështu me radhë shpalosen tek njeriu mrekullitë e krijimit të Zotit.

Dobësia dhe nevoja e shtyjnë njeriun në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Zoti, ato bëhen urë për të gjetur të vërtetën dhe për t'u shkëputur nga lidhjet e përkohshme

si dhe nga ato që mund të quhen "shirk i fshehtë" që bëhen pengesë për njësimin e vërtetë të Zotit në zemër. Është për këtë arsye që Profeti Muhamed s.a.s. duke vijëzuar shembullin e përkryer të besimtarit, thekson rëndësinë e istigfarit duke thënë:

"يَا أَيُّهَا النَّاسُ، تَوَبُّوا إِلَى اللَّهِ وَاسْتَغْفِرُوهُ، فَإِنِّي أَنُوبُ فِي الْيَوْمِ مِائَةَ مَرَّةٍ"

"O njerëz, kthehuni me pendim tek Zoti dhe kërkoni falje prej Tij, sepse me të vërtetë që unë pendothem njëqind herë në ditë".¹

Po, ka gjynahe që i bëjmë pa dijeni, në përhumbje, por ka gjynahe që i bëjmë nga dobësia duke e ditur që këmbët, si shkak i pafuqisë ndaj tundimit të nefsit, qoftë epsh, zemërim, tundim, a lapsus e lëkundje, na shkojnë drejt gabimit e mëkatit, për këtë arsye, istigfari duhet të jetë i vazhdueshëm dhe nuk duhet që kurrsesi të vijë një çast në jetën e besimtarit, kur, Zot ruana, atij t'i vijë në mendje mendimi se nuk ka më nevojë për kërkimfalje se mund të jetë pastruar tërësisht. Ruana Zot, jeta, ditët, orët dhe çastet janë aq të shumta dhe kushdo prej nesh është hapërdarë në ujrat e lodhshme të gafletit e nuk e dimë

1. Muslimi, Dhikr, 42.

se çfarë kemi dërguar në botën e përtejme qoftë nga vepra, fjalët apo edhe nga mendimet tona. Profeti (paqja qoftë mbi të) të cilit i janë falur mëkatet e kaluara dhe të ardhshme, i urdhëron njerëzit të pendohen. Kjo është një metodë edukimi dhe gjithashtu një theksim i rëndësishëm që shkon natyrshëm me karakterin njerëzor. Gjithashtu na njofton se kërkon falje nga Allahu njëqind herë në ditë (edhe pse i janë falur mëkatet) dhe pendohet tek Ai. Duke e bërë këtë, ai inkurajon umetin e tij që të bëjnë të njëjtën gjë.

Ibn Omeri na përcjell se, në një mexhlis të mbledhur, i Dërguari i Allahut (a.s.) u ul dhe tha njëqind herë:

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَتُبْ عَلَيَّ إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ

"Zoti im, falmë, pranomë pendimin se vërtetë ti je Pranues i pendesës dhe je i Mëshirshëm!"²

Rrezatimi i istigfarit

Janë një sërë gjynahesh që ndikojnë në botën tonë shpirtërore dhe nxijnë kudo që prekin, duke shkaktuar tek ndërgjegjia një shkundje të fortë. Hadithet si edhe ajetet kuranore na shpjegojnë në mënyrë të qartë atlasin e ndikueshmërisë që kanë gjynahet në nxirjen e zemrës apo edhe verbërimin e saj, duke shkaktuar eklipse në kraharorët e njerëzve. Këto eklipse, përveçse i bëjnë pritë dritës e nurit hyjnor, nga ana tjetër, hedhin hije edhe në rrezatimet e tjera të jetës dhe të shpalosjes së kaderit hyjnor, duke bërë kështu të ngushtë këtë botë, por edhe tjetrën. Kështu, ka gjynahe që ndërpresin rrizkun, e ka të tjera që ndalojnë mirësitë e Zotit të vijnë, por, Ruana Zot, ka gjynahe që tërheqin më pas në efekt zinxhir zemërimin e Zotit dhe belatë e fatkeqësitë nga të gjitha anët, dhe njeriu i rrokullisur në humnerën e gjynaheve s'ndalet gjersa të përfundojë në zjarr. Kështu, rëndësia e kërkimfaljes dhe pendesës zgjerohet në të gjitha dimensionet e jetës si një parzmore mbrojtëse dhe si një metodologji pastrimi dhe purifikimi.

Thamë që natyra e njeriut është gabimtare, por kurrësi nuk duhet ta bëjmë fakt të kryer këtë gjë dhe të pranojmë e të mundemi në gabim. Është dëshira dhe përpjekja e njeriut për të dalë nga fara e keqe, prej palcës së urrejtjes, ajo që e bën atë të lartësohet në horizontet e larta të krijimit duke u bërë qenia më e ndershme ndër krijesa.

Në një hadith, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) na kumton: "Nëse dikush nuk e lëshon nga gjuha e tij e përmendjes istigfarin (kërkimfaljen), Allahu (xh.sh.) do t'i japë atij rrugëdalje nga çdo ngushtim, lehtësim e shpëtim prej çdo ankthi e mërzitije dhe do ta furnizojë atë me rizik andej nga nuk e pret."³

Istigfari, në fjalë të thjeshta, është tërheqja e robit të Zotit prej egos, epshit, nefsit dhe ndienjave të errëta, duke u përgjyngur drejt Krijuesit me modesti, me varfëri ndaj Tij dhe me pendesë, duke thënë: "O Zoti im! Unë jam i pafuqishëm, Ti je i Fuqishëm dhe i Mëshirshëm! Unë

jam shërbëtori Yt i përlulur që kam nevojë për mëshirën dhe faljen Tënde. Më trego butësinë dhe mëshirën tënde nëpërmjet Bujarisë Sate." Këtë lutje duhet të jetë në gjendje që ta thotë dhe jo ta lërë vetëm me fjalë, por ta përforcojë me vepra të mira, duke përndritur kështu botën e tij të jashtme e njëkohësisht edhe atë të brendshme, pa u ndalur dhe pa u lodhur në rrugën e pastrimit.

Është për shkak të këtyre konsideratave të larta në raportet me Krijuesin ajo që i ka bërë disa prej evlijave të Zotit shpeshherë të luten kështu: "Zoti ynë! Ndërsa ne nuk kishim nevojë as për ekzistencë, as për këtë apo atë gjë, Ti na ke dhënë si bekime edhe gjërat që nuk na duheshin. Tani na duhet robëria e sinqertë. Ne kemi nevojë për Ty dhe mëshirën Tënde. Ne as që ekzistonim, nuk mund të kishim menduar kurrë të ekzistonim, nuk e kishim menduar kurrë të ishim njerëz, s'ishte kjo gjë në mundësitë tona. Këto gjëra nuk ishin ato që na duheshin. Mirëpo Ti u tregove mjaft Bujar për të na i dhënë të gjitha. Megjithatë, tani e tutje ne kemi aq shumë nevojë për Ty që të mund të qëndrojmë në këmbët tona; Ne kemi aq shumë nevojë për Ty që të mos pengohemi e të mos biem... Ne kemi nevojë për Ty aq shumë që të mund të qëndrojmë në rrugën e Xhenetit; Ne kemi aq shumë nevojë për Ty, që të mos ngërthehemi nga dobësitë tona dhe të ecim drejt kënaqësisë Tënde. O Zot, që na jep gjëra që nuk na u deshën! Të kërkojmë atë që na nevojitet..."



2. Ebu Davudi, Vitri, 26/1516; Tirmidhiu, Deavat, 38/3434.

3. Ebu Davudi, Vitri, 26/1518; Ibn-i Mâxhe, Edeb, 57; Ahmed, I, 248; Hâkim, IV, 291/7677.

Dobitë shpirtërore, morale dhe sociale të agjërimit

Muaji i Ramazanit është një adhurim i madh për besimtarët, ku Allahu i shumëfishon shpërblimet për agjëruesit dhe i ngre ata në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, sinqeriteti, humaniteti, uniteti, solidariteti.. virtyte këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërimit në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore, një atmosferë mirëkuptimi, mirësjelljeje, devocioni, një atmosferë bujarie, ndershmërie dhe përgjegjësie, duke i pranuar gabimet dhe duke kërkuar faljen e Zotit.

Devotshmëria është qëllimi i vërtetë i agjërimit dhe, nëse e kuptojmë dhe e pranojmë si qëllim kryesor, atëherë më pas, do të gjejmë të gjitha frytet dhe dobitë e tij. Objektivi final i agjërimit është mirëqenia e njeriut dhe lumturia e tij në të dy botët. Pikësynimin kryesor agjërimi i Ramazanit drejtpërsëdrejti, e ka të thejë faraonësinë dhe imagjinatën prej idhulli të nefsit, duke i bërë të njohur atij dobësinë, varfërinë e pafuqinë, në mënyrë që të fillojë të kryejë adhurimin ndaj Krijuesit të tij. Ai e njofton se është një rob dhe asgjë më tepër.

Njerëzit, nën perden e pakujdesisë të të mirave materiale, nuk arrijnë të vlerësojnë dhe të çmojnë të mirat e Allahut (xh. sh.). Nefsi (egoja) i njeriut nga pakujdesia e harron vetveten, sepse mban dobësinë, varfërinë e pafundme dhe paaftësitë e panumërta. Ai nuk do që t'i shohë ato dhe ta kuptojë se është një i varfër që mund të shkojë drejt zhdukjes. Ky është edhe thelbi i fatkeqësisë, sepse nefsi është një krijesë që është krijuar prej mishi dhe kocke, që do të prishet së shpejti dhe do të ndahet. Ai mendon se ka një trup prej çeliku, që kurrë nuk do të zhduket, prandaj sulet pas interesave të kësaj bote, duke imagjinuar se nuk do të vdesë. Me një ambicie të tmerrshme dhe me një lidhje të fortë pas kësaj bote, bën çdo përpjekje. Tërhiqet pas çdo gjëje që është e shijshme dhe e vlefshme, duke e harruar Krijuesin që e edukon me mëshirën e pasosur. Më në fund, rrokulliset në moralin e keq, duke mos menduar për përfundimin e jetës, sepse edhe ai do të vdesë një ditë dhe do të ikë në jetën e përjetshme.

Agjërimi i Ramazanit u tregon njerëzve dobësinë, varfërinë dhe pakujdesinë e tyre. Për shkak të urisë, ata mendojnë stomakun dhe e pranojnë nevojën e tij. Me anë të urisë së agjërimit, njeriu e kujton se sa mashtrues është trupi i tij dhe e pranon se ka nevojë për Mëshirën e Allahut (xh.sh.). Uria e

shtyn të braktisë idhujtarinë e nefsit dhe të pranojë dobësinë e varfërinë e tij. Në këtë mënyrë i zgjohet dëshira që të mbështetet në praninë e Allahut (xh.sh.).

Për jetën individuale, agjërimi është një ilaç me shumë efekt. Nga pikëpamja mjekësore është një dietë e mirë, sepse njeriu kur ha më tepër se sa duhet dhe pa kontroll, e dëmton stomakun, gjë që mund t'i shkatërrojë shëndetin. Duke gjykuar në këtë formë, ai mund të bëhet i pavëmendshëm edhe për ushqimet e palejuara, gjë që do ta shqetësojë shumë shpirtërisht, jo vetëm për këtë jetë por edhe për tjetrën. Kjo vepër e papëlqyer bëhet shkak që zemra dhe shpirti të mos u binden urdhrave të fesë Islame. Në këtë moment, nefsi i pakujdesshëm i merr në dorë frerët e njeriut dhe e sundon atë, duke e çuar ku të dojë vetë.

Me agjërimin e Ramazanit njeriu mësohet të mbajë dietë. Kështu nefsi mësohet t'i bindet urdhrave dhe stomaku shpëton nga pesha e rëndë e bluarjes, i cili bëhet shkak që njeriu të sëmuret shpesh. Njeriu gjatë muajit të Ramazanit disiplinohet, që ai të mos i sulet haramit duke braktisur hallallin. Ai e mëson njeriun ta kuptojë se qëllimi i krijimit të tij është të mos e shkatërrojë jetën shpirtërore.

Njeriu në jetën e tij në shumë raste përballet me urinë. Agjërimi i Ramazanit është një lloj ushtrimi, që ia kalit durimin njeriut. Ai zgjat rreth pesëmbëdhjetë orë në ditë dhe po të mos hahet syfy, ai zgjat njëzetekatër orë. Pra, për të kalitur durimin, ky është një ushtrim shumë i mirë dhe një ilaç për atë që nuk duron dot fatkeqësinë dhe nuk ka rezistencën e duhur. Profeti (a.s.) thotë: "Agjërimi është gjysma e durimit, kurse pastërtia është gjysma e besimit" (Tirmidhi, Daavat, 85; Ibn Maxhe, Sijam, 44; Ahmed, 4/260). "Fabrika" e stomakut (lukthit) ka shumë anë shpirtërore, sepse pajisjet e saj kanë kontakt me vetë njeriun. Po qe se nefsi nuk e duron urinë e një muaji, atëherë sundimin e merr në dorë ai dhe bëhet shkaktari i veseve të tjera, duke u dhënë pas tij dhe duke harruar detyrat e adhurimit.

Agjërimi është lartësim i shpirtit, ushtrim për përforcimin e trurit dhe nxitës për bamirësi. Ai synon ngritjen e ndërgjegjes së individit, ndriçimin e mendjes dhe zbardhjen e zemrës. Ai është një adhurim edukativo-moral, i cili synon edukimin fizik e shpirtëror të njeriut, ku e përgatit atë përballë sprovave me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Nëpërmjet agjërimit



njeriu aftësohet për të disiplinuar dëshirat e tij dhe ka vullnet e fuqi për të kryer çdo punë me përpikëri. Duke agjëruar, njeriu mënjanon me ndërgjegje ushqimin sipas orarit të caktuar nga agimi deri në perëndim të diellit, largon mendimet dhe sjelljet e pahijshme dhe shton ndjenjën e tolerancës aq të nevojshme për shoqërinë ku jetojmë, duke kontribuar kështu për harmonizimin e raporteve në familje, punë dhe shoqëri.

Të privosh veten nga gjërat thelbësore të jetës, nuk është një akt i lehtë. Kjo kërkon një personalitet të fortë për të patur një vetkontroll, vetëdisiplinë dhe vetëpërbajtje. Ky program vetushtrues gjatë muajit të Ramazanit, ka rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Një besimtar që mund të përbajë veten nga gjërat thelbësore të jetës për një kohë të caktuar dhe kur këtë e bën për hir të dashurisë për Allahun, meriton një shpërblim nga vetë Krijuesi. Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: "Ka shumë njerëz që agjërojnë, e nga kjo nuk kanë asgjë, përveç urisë dhe etjes. Ka shumë njerëz që luten natën, e asgjë nuk ka nga kjo lutje, përveç pagjumësisë, i këtillë është çdo njeri, i cili nuk e kryen këtë veprim me besnikëri dhe sinqeritet të plotë" (Ibn Maxhe, Sijam, 21).

Gjatë agjërit në muajin e Ramazanit, myslimanët mësohen të kontrollojnë emocionet e tyre dhe të kenë durim, durim ndaj të gjitha llojeve të sprovave dhe shqetësimeve. Agjërimi është mjeti më i mirë për rrënjosjen e moralit. Përsosmëria e tij më e madhe është se ashtu siç na largon nga nevojat e stomakut, na pastron edhe nga zilia e shqisave; syri, veshi, gjuha, zemra apo mendimet e liga të imagjinatës. Domethënë secilës shqisë i ndalohet të ndërhyjë në shijime të ndaluara dhe të padobishme. Për shembull, syrin e ndalon nga vështrimi i haramëve dhe nga lëvizjet në vende të dyshimta, kurse veshin e drejton të mos dëgjojë fjalët e liga, por Kur'anin dhe fjalët e drejta. Në këtë mënyrë edhe shqisat e tjera i shtyn të agjërojnë në këtë muaj të ndritur.

Gjatë agjërit urrejtja dhe zemërimi personal janë në nivelin më të ulët. Myslmanët mbajnë parasysht keshillat e të dërguarit të Allahut: "Po qe se, ndërsa jeni të agjëruar, dikush ju ofendon ose ju godet, thojini: Unë jam me agjërim" (Buhari, Saum, 2; Muslim, Sijam, 161; Tirmidhi, Saum, 54). "Zoti nuk ka nevojë që njeriu të braktisë ushqimin dhe pijen, nëse ai nuk braktis fjalën e keqe dhe veprën e ligë" (Buhari, Saum, 8; Ebu Daud, Saum, 25; Tirmidhi, Saum, 16). Për këtë arsye

Profeti (a.s.) e quan agjërimin mburojë, sepse mbron zemrën nga ligësitë dhe gjymtyrët nga veprat e shëmtuara. Nëpërmjet agjërit njeriu vlerëson të mirat e kufizuara që i ka dhënë Zoti. Kështu, ai bëhet i thjeshtë, i sinqertë dhe mirënjohës ndaj Allahut të Madhëruar.

Zoti ka krijuar njerëzit me kapacitete të ndryshme fizike, emocionale, intelektuale dhe shpirtërore. Ai na ka bërë të gjithëve ne të kemi nevojë për njëri-tjetrin për përfitime të dyanshme. Nga kjo, nënkuptohet që Ramazani dhe respektivisht agjërimi ka rëndësi sociale, se secili person kërkon me veprimet e tij të dalë në dritë e gjithë shoqëria Islame, duke u bërë kështu të devotshëm, të mirëorganizuar dhe të mirëdisiplinuar. Pra, kjo shoqëri myslimane në këtë muaj, jeton dhe punon sipas kodit hyjnor moral të shkruar në Kur'anin e shenjtë që ka zbritur në këtë muaj.

Falë agjërit të Ramazanit, në jetën shoqërore njeriu krijon lidhje të ndryshme me njerëzit e tjerë. Me këtë, ai ndjen një lidhje të fuqishme ndaj tyre. Bashkë me të gjithë besimtarët, fillimi i agjërit në të njëjtin çast, pritja e iftarit, ngritja në syfy, falja e teravive me xhemat, gdhirja e natës së kadrut, hyrja në bajram etj., bëhen shkak për një vëllazëri shumë të shëndoshë dhe për një dashuri të vërtetë. Kështu, besimtarët bëhen si gjymtyrë të një trupi të vetëm, ashtu siç shprehet edhe Profeti ynë: "Në dashurinë për njëri-tjetrin, në dhimbjen për njëri-tjetrin dhe në dhembshurinë për njëri-tjetrin, besimtarët janë si një trup i vetëm. Po qe se një organ ankohet, organet e tjera rrinë pa gjumë e rënkojnë." (Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr, 66; Ahmed b. Hanbel, 4/270). Me këtë mendim të lartë, në shoqëri ngrihen bashkimi dhe uniteti.

Pritja e iftarit rreth sofrës nga të gjithë pjesëtarët e familjes së bashku, ku sot mungon shumë, i lidh më shumë këta njerëz me njëri-tjetrin. Kjo situatë e pritjes së iftarit është shumë e rëndësishme sidomos për shtimin e afërsisë dhe dashurisë mes individëve të familjes, domethënë për realizimin e ngritjes së familjes mbi themele më të shëndosha. Kjo duhet të jetë edhe njëra prej urtësive të faktit që Islami kërkon që e gjithë familja të ulet së bashku në sofrën e iftarit dhe ashtu ta presë atë. Pritja e iftarit i hap rrugë forcimit të lidhjeve të afërsisë dhe dashurisë sa mes pjesëtarëve të familjes, aq dhe me anë të ftesave, mes të ftuarve, të njohurve, miqve, madje edhe të panjohurve fare.

01 NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E HAXHIT PËR VITIN 2025 NË XHIDE TË ARABISË SAUDITE



Me ftesë të ministrit të Ministrisë së Haxhit dhe Umres të Arabisë Saudite, Dr. Tevfik b. Feuzan er-Rabiah, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i shoqëruar nga përfaqësues të tjerë të institucionit, zhvilloi një vizitë disa ditore në qytetin e Xhides, në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Gjatë qëndrimit të tij, Kryetari Spahiu u prit në një takim të veçantë nga Ministri er-Rabiah, ku të dy nënshkruan marrëveshjen e Haxhit për vitin 2025. Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e procedurave dhe lehtësimin e organizimit të Haxhit për besimtarët shqiptarë, duke siguruar një realizim sa më të suksesshëm dhe të sigurt të këtij rituali.

Kryetari Spahiu falënderoi autoritetet saudite për përkushtimin dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm për thjeshtimin e procedurave administrative dhe lehtësimin e udhëtimit për besimtarët shqiptarë. Ai gjithashtu shprehu mirënjohjen e thellë për kujdesin dhe shërbimet e larta që ofrohen për haxhilerët nga gjithë bota. Po ashtu, Kryetari Spahiu vlerësoi kushtet e përmirësuara dhe mundësitë komode që janë krijuar për besimtarët që realizojnë Umren gjatë gjithë vitit.

Nga ana e tij, Ministri er-Rabiah shprehu mirënjohje të thellë për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, duke e vlerësuar për organizimin e shkëlqyer dhe korrekt të ritualit të Haxhit për besimtarët shqiptarë ndër vite. Ai theksoi se haxhilerët shqiptarë janë gjithmonë të mirëpritur në vendin që strehon dy xhamitë e shenjta.



02 NUNCI APOSTOLIK VIZITON KMSH-NË NË PËRFUNDIM TË MISIONIT TË TIJ DIPLOMATIK NË SHQIPËRI



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim lamtumire në selinë e institucionit, Nuncin Apostolik në Shqipëri, z. Luigi Bonazzi.

Gjatë fjalës së tij, kryetari Spahiu e falenderoi Nuncin për marrëdhënien mjaft bashkëpunuese dhe të frytshme që ka pasur gjatë misionit të tij diplomatik në Shqipëri. Ai i uroi suksese në përgjegjësitë e mëtejshme.

Nga ana e tij, Nunci Apostolik shprehu vlerësim të veçantë për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, duke e cilësuar atë si një institucion me vizion të qartë në ruajtjen e balancave dhe në kontributin për shoqërinë shqiptare. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërfaqet dhe rolin pozitiv që ky institucion luan në jetën sociale të vendit.

Gjatë kësaj kohe, z. Bonazzi ka kontribuar në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe Shqipërisë, duke promovuar dialogun ndërfaqet dhe bashkëpunimin ndër institucional. Në këtë aspekt, përmendim edhe pritjen nga Papa Françesku të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, në një vizitë zyrtare më 6 maj 2022, në Selinë e Shenjtë në Vatikan.

Z. Luigi Bonazzi, filloi misionin e tij si Nunci Apostolik në Shqipëri më 10 janar 2021, pas emërimit nga Papa Françesku më 10 dhjetor 2020. Misioni i tij përfundon më 21 janar 2025, duke shënuar një periudhë shërbimi prej katër vitesh.



03 VIZITË PUNE NË MYFTININË KAMËZ



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, së bashku me anëtarë të tjerë të kryesisë së institucionit, zhvilluan një vizitë pune në Myftininë e Kamzës, ku u pritën nga Myftiu Islam Hoxha, administratori dhe imamët përkatës.

Kjo vizitë, pjesë e një ture të gjerë vizitash pune në myftinitë e vendit, kishte për qëllim monitorimin dhe mbështetjen në terren të realizimit të objektivave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme lidhur me planin strategjik të punës për periudhën 2024-2029.

Gjatë takimit, Myftiu Hoxha paraqiti një përmbledhje të detajuar të aktiviteteve dhe arritjeve të myftinisë, duke nxjerrë në pah përpjekjet e vazhdueshme në përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe shërbimeve fetare. Ai theksoi gjithashtu iniciativat për rritjen e nivelit të arsimit fetar nëpërmjet kurseve dhe sfidat që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, e përgëzoi Myftiun dhe imamët për angazhimin e palodhur dhe arritjet e deritanishme. Më tej ai theksoi rëndësinë e vazhdimësisë në përmbushjen e objektivave strategjike dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet myftinisë dhe institucioneve publike e ato private, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm në shoqëri.

Takimi vazhdoi më tej në formën e një bashkëbisedimi të hapur, ku u diskutuan tema të ndryshme, përfshirë rëndësinë e edukatës fetare për rininë, përmirësimin e infrastrukturës së objekteve fetare, etj.



04 FIRMOSET MARRËVESHJA PËR PROJEKTIN E SHPORTËS SË RAMAZANIT PËR VITIN 2025



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti sot në një takim z. Fehd bin Najif el-Beuardi dhe z. Muhamed bin Khaled el-Kalai, përfaqësues të Qendrës Mbreti Selman për Bamirësi dhe Ndihma Humanitare me seli në Rijad të Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Gjatë këtij takimi, kryetari Spahiu dhe përfaqësuesit e qendrës firmosën marrëveshjen e bashkëpunimit për zbatimin nga ana e KMSH-së të projektit të Shportës së Ramazanit 2025.

Falë këtij projekti, me mbështetjen e qendrës në fjalë, KMSH do t'u vijë në ndihmë rreth 5650 familjeve nevojtare në mbarë vendin nëpërmjet Myftinive nëpër rrethe, me shporta ushqimore të mjaftueshme për një muaj.

Kjo traditë bashkëpunimi ndërmjet një prej qendrave humanitare më të fuqishme në lindjen e mesme dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë vazhdon me sukses prej tashmë 10 vitesh në vendin tonë.





Njohja

e njeriut ndaj vetes së tij

Të urtët (hukama') kanë thënë: "Gjëja e parë që është e nevojshme për insanin është të njohë veten e tij (ma'refetu'n-nefs)." Ata gjithashtu kanë thënë: "Gjëja e parë që është e nevojshme për njeriun është të njohë Zotin (ma'refetu'l-llah)." Nuk ka kundërshtim mes këtyre dy pohimeve. Me "gjëja e parë," kur thanë njohjen e vetës (en-nefs), ata nënkuptuan të parën nga perspektiva e radhitjes logjike. Ndërsa me "gjëja e parë," kur thanë njohjen e Zotit, ata nënkuptuan të parën në kuptimin e vlerës dhe nderit më të lartë të asaj njohjeje. Sepse, me të vërtetë, njohja e Zotit është më e mira dhe më e ndershmja prej të gjitha njohurive (afdal mearif).

Dhe në njohjen e vetes ka një vetëdije për disa gjëra:

Së pari: Duke njohur veten, njeriu mund të arrijë njohjen e gjithçkaje që është përtej vetes; por nëse është injorant për vetën e tij, atëherë është injorant për çdo gjë tjetër (xhehl).

Së dyti: Shpirti njerëzor është pika e bashkimit të të gjitha gjërave që ekzistojnë (mevxhudat), siç do ta sqarojmë më vonë—kështu që, ai që njeh shpirtin njerëzor njeh të gjitha gjërat që ekzistojnë. Kështu, Zoti thotë: "A nuk e kanë përsiatur ata veten e tyre? Zoti nuk i krijoi qiejtë dhe tokën, dhe atë që është mes tyre, përveçse me të vërtetën dhe për një afat të caktuar. Por, me të vërtetë, shumë njerëz nuk besojnë në takimin me Zotin e tyre." (er-Rum, 30:8)

Ky ajet na tërheq vëmendjen për faktin se, po të kishin reflektuar thellë (tedebbaru) mbi shpirtat e tyre dhe t'i njihnin ata, do të njihnin përmes kësaj njohjeje realitetin e të gjitha gjërave ekzistente: ato të përhershme dhe ato të përkohshme. Dhe ata do të kuptonin të vërtetën e qiejve dhe të tokës. Dhe nuk do ta mohanin Ringjalljen (el-ba'th), e cila është takimi me Zotin e tyre, vetëm sepse dështuan të reflektojnë thellë mbi vetët e tyre. Zoti thotë: "Ne do t'ua tregojmë atyre shenjat Tona në horizonte dhe në vetë shpirtat e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se ajo është e vërteta." (Fussilet, 41:53). Po ashtu ai thotë: "Edhe në tokë ka shenja për ata që kanë bindje të sigurt, ashtu edhe në vetë shpirtat tuaj. A nuk do të kuptoni atëherë?" (edh-Dharijat, 51: 20-21)

Së treti: Kush e njeh veten e tij, njeh botën ('alem). Dhe ai që njeh botën është në kategorinë e atij që dëshmon për Zotin, pasi Ai krijon qiejt dhe tokën. Ai nuk do të jetë si injorantët mosmirënjohës, të cilëve Zoti ua ka mohuar këtë pozitë. Zoti thotë për ta: "Unë nuk i bëra ata dëshmitarë të krijimit të qiejve dhe të tokës, as të krijimit të vetë atyre. Dhe nuk i marr si ndihmës ata që çojnë të tjerët në humbje." (el-Kehf, 18:51)

Së katërti: Kush e njeh shpirtin e tij (ruhuhu), do të njohë botën shpirtërore dhe përjetësinë e saj.

Ashtu si ai që e njeh trupin e tij, njeh botën materiale dhe kalueshmërinë e saj. Kështu, ai do të kuptojë pavlerësinë e gjërave të përkohshme (el-faniyet) dhe do të njohë fisnikërinë dhe nderin e gjërave që janë të qëndrueshme dhe të përjetshme (el-bakijatu's-salihat).

Së pesti: Kush e njeh shpirtin e tij, do të njohë armiqtë e fshehur brenda tij. Pejgamberi (a.s) ka bërë referencë për këtë: "Armiku yt më i madh që ke, është vetja jote mes dy anëve të tua." Prandaj, ai kërkon mbrojtje nga Allahu prej tij dhe prej së keqes që ai përmban. Pejgamberi ka thënë: "O Allah, më frymëzo në veprimet e mia (rushdi) dhe më mbro nga e keqja e nefsit tim." Gjithashtu Ai (a.s) ka thënë: "Mos më lër të mbështetem te vetja ime as sa hap e mbyll sytë, sepse do të shkatërrohem."

Kush e njeh armikun e tij të fshehtë dhe mekanizmat e tij, dhe natyrën e asaj që i nxit ato, ky person do të jetë në gjendje të mbrohet nga ato. Ai do të jetë në gjendje të luftojë kundër tyre për të qenë i denjë për atë që Zoti u ka premtuar atyre që luftojnë në rrugën e Zotit. Nëse ai nuk e njeh armikun e tij të fshehtë, atëherë është e lehtë që armiku të duket para tij, dhe ky armik është dëshira e tij (el-heva) në forma e arsyes (el-'akl); dhe kjo do ta bëjë gënjeshtër/të kotën të duket si e vërtetë. Pejgamberi ka thënë: "Dëshira [e pakontrolluar] është një shejtan." Gjithashtu Pejgamberi ka thënë: "Ajo [dëshira] adhurohet si një zot në vend të Zotit."

Po ashtu, transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Asnjë zot që është adhuroar në tokë nuk është më i urreyer për Zotin se sa pasionet e pakontrolluara."

"A e ke parë atë që e ka marrë dëshirën e tij (hevehu) si hyjni të tij (ilehehu)?" (El-Xhathijje, 45:23)

Gjashtë: Kushdo që e njeh shpirtin e tij, do të bëhet i mirë në zotërimin e tij. Dhe kushdo që është i mirë në kontrollimin e shpirtit të tij, do të bëhet i mirë në qeverisjen e botës, dhe do të bëhet njëri nga mëkëmbësit e Zotit, të cilët Ai i përmend në këtë ajet:

"Dhe ju bëjmë trashëgimtarë në tokë." (El-A'raf, 7:129)

Dhe ai do të vendosët në mesin e liderve të cilët Zoti i ka përmendur në këtë ajet:

"...dhe do t'ju bëj juve udhëheqës (muluk)" (El-Ma'ideh, 5:20)

Shtatë: Kushdo që e njeh shpirtin e tij, nuk do të gjejë asnjë të metë tek të tjerët pa e parë atë të metë tek vetja e tij, qoftë ajo e dukshme ose e fshehur, si zjarri në shkëmb. Ai nuk është një gjetës i të metave, as një shpifës, as një kritikues. Çdo të metë që ai gjen tek të tjerët, do ta gjejë edhe tek vetja. Dhe ai që sheh të metat e tij, do të jetë mes atyre për të cilët Pejgamberi është lutur kur ka

thënë:: "Zoti e mëshiroftë atë që të metat e tij ia kanë marrë vëmendjen nga të metat e të tjerëve."

Është e vështirë të njohësh të metat e tua, sepse njerëzit e duan veten e tyre. Dashuria për veten do t'i verbërojë ata nga të metat personale. Pejgamberi ka thënë: "Dashuria juaj për një gjë do t'ju bëjë të verbër dhe të shurdhër." Dhe dikush që është i verbër dhe i shurdhër ndaj të metave të një gjëje mund ta bëjë atë tërheqëse (ju'xheb) për të. Nuk ka dëm më të keq për një njeri se sa të jetë i dashuruar me veten e tij. Siç kanë thënë disa nga njerëzit e urtë: "Gënjeshitari është shumë larg të vërtetës, dhe ai që e admiron veten është në një gjendje më të keqe se gënjeshitari, sepse gënjeshitari gënjen vetëm me fjalët e tij, por ai që e admiron veten gënjen me fjalët dhe veprat e tij."

Po kështu urtarët kanë thënë: 'Dhe më keq se të dy ata është ai që është i dashuruar me veten e tij (el-mu'xheb bi nefsihi). Sepse gënjeshitari dhe ai që adhuron veten mund të jenë të dobishëm për njerëzit, por nuk ka asnjë dobi nga ai që është i magjepsur me veten e tij. Mund të këshillosh dy të parët dhe kjo këshillë mund të ketë një efekt të dobishëm mbi ta për shkak të njohurive të tyre për veten, por ai që është i dashuruar me veten e tij për shkak të injorancës ndaj shpirtit të tij, e mendon këshillën si fjalë të kotë.

Tetë: Kushdo që e njeh shpirtin e tij, e njeh Zotin. Është transmetuar se nuk ka asnjë libër që Zoti ka shpallur, përveçse ka diçka në të që është ngjashëm me: "Njihu me veten tënde, o njeri, dhe do të njohësh Zotin tënd." Dhe kjo është kuptimi i ajetit: "Ne do t'ua shfaqim atyre shenjat Tona në horizont dhe në vetet e tyre derisa t'u bëhet e qartë atyre se është e vërteta." (Fussilet, 41:53)

Ka tre interpretime për këto fjalë:

I pari është se njohja e vetes do t'ju mundësojë të arrini njohjen e Zotit. Ashtu siç themi: 'Njih arabishten dhe do të jesh në gjendje të njohësh shkencën e el-fikh'ut (jurisprudencën Islame). Kjo do të thotë se njohja e arabishtes është një mjet që ju mundëson të njihni jurisprudencën, edhe pse ka ndërmjetës midis tyre.

Kuptimi i dytë është: nëse arrihet njohja e vetes, atëherë njohja e Zotit arrihet pa asnjë pengesë (fasil). Ky është kuptimi i fjalëve: 'Kur dielli lind, ka dritë.' Në fjalë të tjera, drita është e lidhur me lindjen e diellit; ajo nuk vonohet në kohë.

Kuptimi i tretë është: njohja e Zotit nuk është e qëndrueshme, nëse nuk njeh vetën, sepse nëse e njeh shpirtin në realitet, do të njohësh botën. Dhe nëse e njeh botën, do të dish se ajo është krijuar (muhdeth), dhe do të dish se ka një Krijues (Muhdith) që nuk ngjan me gjërat e krijuara në asnjë mënyrë,

formë apo figurë. Kjo është shkalla (ghajet) e njohjes suaj të Zotit (ma'rifet'u-llah).

Po ashtu është thënë, dhe kuptimi i kësaj tregohet nga fjalët e Prijësit të Besimtarëve 'Omerit (r.a): "Mendja ('akl) është për të vendosur adhurimin dhe robërinë tonë ndaj Zotit, jo për të arritur (idrak) realitetin e Zotit tonë.", dhe më pas thuri këto vargje:

Ashtu si askush nuk e njeh thelbin e vetes së tij,

Si mund ta njohësh Xhebarin në përjetësinë e Tij?

Është Ai që krijoi gjithçka në fillim,

Si mund ta kuptojë një shpirt i krijuar Atë që është i Përjetshëm?

Po ashtu ai ka thënë:

Paaftësia për ta njohur plotësisht Zotin është vetë dije.

Përpjekja për të depërtuar në misterin e Esencës së Tij është shirk.

Dhe në dëshirat e fshehta të krijimit fshihen shumë mistere,

që as xhindet e as engjëjt nuk mund t'i kuptojnë.

Nga Ai te Ai është udhëzimi,

Dhe veliu i Allahut është ai që do të arrijë.

Dhe Ebu Bekr es-Siddik (r.a) tha: "O njeri, arritja e njohjes së Tij është të mos mundësh ta njohësh plotësisht." Dhe Zoti ka thënë "... e harruan Zotin, dhe Zoti i bëri që ata të harrojnë vetën e tyre." (el-Hashr, 59:19)

Kjo na kujton se, po ta njihnin veten e tyre, do të dinin për Zotin. Por nëse nuk kanë njohuri për veten e tyre, kjo injorancë tregon për mosnjohjen e Zotit të tyre.¹

Përktheu nga arabishtja: Haki Sahitaj

1. Burimi: el-Imam Ebil-Kasim el-Husejn bin Muhammed bin Mufaddal er-Ragib el-Isfahani, Tafsilu'n-nesh'etejn ve tahsilu's-se'adetejn, Bejrut, 1898 (1319h), fq. 10-14.



Muaji i Madhërishëm i Ramazanit përmes pyetjeve I

1. Çfarë është agjërimi?

Agjërimi është të largohesh nga ngrënia, pirja dhe kryerja e marrëdhënieve intime, me qëllimin e adhurimit, që nga agimi deri në perëndimin e diellit.

2. Cili është gjykimi rreth agjëritit të Ramazanit?

Një nga pesë shtyllat e Islamit është agjërimi i muajit të Ramazanit. Nisur nga kjo agjërimi i këtij muaji është farz, pra detyrim.

3. Kush e ka detyrim agjërimin e Ramazanit?

Agjërimin e muajit Ramazan e kanë detyrim personat që përmbushin kushtet e mëposhtme:

- Të jetë mysliman.
- Të ketë mbushur moshën e pubertetit dhe të jetë i aftë mendërisht.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të agjëruar dhe të mos jetë udhëtar.

4. Kush nuk e ka detyrim agjërimin e Ramazanit?

Personat që janë myslimanë dhe kanë zhvillim mendor normal në disa raste nuk e kanë detyrim agjërimin:

- Sëmundja që e dëmton agjëruesin ose ia vonon shërimin.
- Udhëtimi, pra statusi fetar i udhëtarit.
- Të përmuajshmet e grave dhe lehonja. Në këtë rast gruaja jo vetëm që lirohet nga detyrimi, por madje nuk i lejohet të agjërojë dhe as të falë namaz. Agjërimin e bën kaza më pas.
- Shtatzënia dhe ushqimi i fëmijës me gjë (mëkimi).
- Njeriu aq i moshuar, sa që nuk e përballon dot agjërimin.
- Si dhe rastet e veçanta të mundimshme si puna e rëndë fizike, lufta, presioni apo dhuna fizike.

Përveç grave në të përmuajshme dhe lehone, rastet e tjera kanë leje të mos agjërojnë. Por nëse agjërojnë, u quhet.

5. Kur bëhet nijeti për agjërimin e Ramazanit?

Nijeti i bërë në hyrje të Ramazanit për agjërimin e tij të plotë është i mjaftueshëm për të gjithë muajin. Ndërkaq nijeti ditor mund të bëhet nga akshami deri në mesditë. Pra nuk mund të niset agjërimi pas hyrjes së vaktit të drekës. Prandaj më e përshtatshme është të ngrihesh në syfyr, të ushqehesh me diçka dhe të bësh nijetin.

6. Kur fillon dhe përfundon agjërimi gjatë ditës?

Agjërimi fillon me hyrjen e vaktit të namazit të sabahut. Me hyrjen e vaktit sipas orarit të imsakut të shkruar në kalendar, që nënkupton edhe thirrjen e ezanit të sabahut, nis agjërimi. Një kafshatë pas këtij orari prish agjërimin e tërë ditës. Agjërimi përfundon me hyrjen e namazit të akshamit.

7. Cila është vlera e syfyrin dhe iftarit?

Profeti, paqja qoftë mbi të, ka thënë kështu: "Në syfyr ka

bereqet. Kurrresi të mos rrini pa u ngritur në syfyr, qoftë edhe për të pirë një gllënkë ujë, sepse Allahu (xh.xh.) dhe engjëjt bëjnë lutje për ata që ngrihen në syfyr!" (Ahmed b. Hanbel, 3/12, 32, 44, 99)

Si dhe ka thënë: "Umeti im do të ketë mbarësi, për sa kohë që do ta shpejtojë iftarin dhe do ta shtyjë syfyrin!" (Ebu Daud, Saum, 21; Ahmed b. Hanbel, 2/450)

8. Si është duaja e iftarit?

Duke pasur si burim fjalët e Profetit (a.s) duaja e mëposhtme është dukshëm e përhapur ndër besimtarët:

اللَّهُمَّ لَكَ صُمْتُ وَعَلَى رِزْقِكَ أَفْطَرْتُ وَبِكَ آمَنْتُ وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ
ذَهَبَ الظَّمَأُ وَابْتَلَّتِ الْعُرُوقُ وَثَبَتَ الْأَجْرُ إِنْ شَاءَ اللَّهُ

Allahumme leke sumtu ue ala rizkike eftartu ue bike amentu e alejke teuekkeltu,

Dhehebedh'dhameu uebtel'letil'uruku ue thebetel'exhru insha Allahu.

"Allahu im, vetëm për Ty agjërova, me rizkun Tënd (atë që më ke dhënë) bëra iftar, Ty të besova, te Ti u mbështeta. Shkoi etja, u lagën venat dhe shpërblimi u arrit, në dashtë Allahu."

Krahas kësaj personi mund të lutet si të dëshirojë.

9. Çfarë e prish agjërimin?

Parimisht çdo gjë me vlera ushqyese që hyn në trupin e njeriut e prish agjërimin. Pastaj detajet janë të ndryshme. P.sh.:

- nëse personi gëlltit me vetëdije diçka të pazakonshme si dheu apo tymi;
- nëse gëlltit diçka ushqyese pa dashje, si uji;
- kalimi në grykë i ujit të marrë me gojë ose të tërhequr me hundë, gjatë marrjes së abdesit;
- ngrënia ose pirja me dashje pasi që të ketë ngrënë ose pirë diçka me harresë duke pandehur se është prishur agjërimi;

-marrëdhëniet intime;

-menstruacionet dhe gjakderdhja pas lindjes, etj.

10. Çfarë nuk e prish agjërimin?

Nuk e prishin agjërimin situatat e mëposhtme:

- ngrënia me harresë e çfarëdolloj gjëje,
- gëlltitja pa dashje e gjërave që janë të pazakonta për ushqyerje, si tymi apo dheu,
- të vjellësh pa dashje,
- gjaku në sasi të vogël që del nga dhëmbët,
- të lahesh,
- të lash dhëmbët, etj.

11. A prishet agjërimi nëse ushqehemi me harresë?

Të ushqehesh me harresë do të thotë "duke harruar që je agjërueshëm". Kjo është quajtur nga Profeti Muhamed (s.a.s) si qerasje e Allahut ndaj robit të Tij, prandaj nuk e prish agjërimin. Sigurisht personi duhet të ndalojë ngrënien në momentin që kujtohet se është agjërueshëm. Nëse vijon edhe pasi kujtohet, atëherë agjërimi prishet.

12. A prishet agjërimi nëse ushqehemi pa dashje?

Të ushqehesh pa dashje teknikisht do të thotë që të gëlltisësh diçka pa harruar se je agjërueshëm. Në këtë rast agjërimi prishet dhe duhet zëvendësuar me një ditë kaza.

13. A e prishin agjërimin vaksina dhe injeksioni?

Në lidhje me çështjen ka dy qasje. Sipas njërës prej tyre agjërimi prishet nëse vaksinohehi ose bëjmë çfarëdolloj injeksioni. Sipas qasjes së dytë dhe më të përhapur aktualisht, nëse vaksina apo injeksioni nuk përmban vlera ushqyese, atëherë kjo nuk e prish agjërimin sepse është diçka jo e zakonshme për ushqyerjen dhe injektohet në trupin e njeriut si detyrim shëndetësor. Në situatën e Covid-19 u dha botërisht fetva që vaksinimi nuk e prish agjërimin. Secili besimtar mund të veprojë sipas njërës prej këtyre dy qasjeve.

14. Si zëvendësohet një ditë agjërimi e panisur?

Një ditë agjërimi e panisur zëvendësohet po me një ditë agjërim jashtë Ramazanit.

15. Si zëvendësohet një ditë agjërimi që është nisur dhe prishur pa dashje?

Një ditë agjërimi që është nisur dhe prishur pa dashje, zëvendësohet po me një ditë agjërim jashtë Ramazanit.

16. Si zëvendësohet një ditë agjërimi që është nisur dhe prishur me dashje (pa arsye)?

Një ditë agjërimi që është nisur dhe prishur me dashje dhe pa asnjë arsye, zëvendësohet me një ditë agjërim jashtë Ramazanit. Por duke qenë se ky është një mëkat i madh, është detyrim të agjërohen edhe 60 ditë të njëpasnjëshme si shlyrje e këtij mëkati. 60 ditët nuk duhet të ndalojnë asnjëherë, përndryshe duhet të nisin nga fillimi. Ky quhet kefare. Çdo Ramadan ka maksimumi një kefare. Nëse një person e prish agjërimin dy ditë të ndryshme në të njëjtin ramazan, atëherë bën dy ditë kaza, por vetëm një 60 ditësh.

17. Çfarë duhet të bëjë një person që nuk agjëron dot për shkaqe shëndetësore?

Nëse mjeku mysliman e ka diagnostikuar me një shqetësim që kurrë më në jetë nuk do të ketë mundësi të agjërojë, atëherë jep fidje për çdo ditë Ramazani. Nëse ka një sëmundje të përkohshme nga e cila do të gjejë shërim, atëherë nuk agjëron derisa të shërohet dhe i bën kaza ditët pas Ramazanit.

18. Çfarë është fidja dhe kur jepet ajo?

Fidja është detyrimi që japin njerëzit, të cilët nuk mund të agjërojnë më kurrë në jetën e tyre për shkak të pleqërisë ose të ndonjë sëmundjeje të vazhdueshme dhe të pashërueshme. Sasia minimale e saj është sa të ushqehet një person dy vakte për çdo ditë të paagjësuar. Kjo është e barabartë me shumën e sadakasë së fitrit, e cila zakonisht përcaktohet çdo vit nga institucionet përfaqësuese islame

dhe bëhet publike pak para nisjes së muajit Ramazan. Fidja i jepet të varfërve dhe nevojtarëve.

19. Çfarë janë teravitë?

Teravitë janë namaz suplementar (sunset), që karakterizojnë muajin Ramazan. Ato falen pas suneteve të namazit të jacisë dhe para namazit të vitrit. Profeti (a.s) i ka falur disa ditë me xhemat dhe pastaj individualisht, në mënyrë që mos të kuptoheshin si detyrim. Historikisht praktika e përhapur në çdo vend mysliman është 20 rekate. Për lehtësim, në vende të ndryshme, falen edhe 8 rekate e më sipër.

20. Sa rekate janë teravitë?

Teravitë janë sunset i kategorisë së namazit të natës. Si dy rekate, po ashtu edhe më shumë të falësh quhen namaz teravie. Është transmetuar që Profeti (a.s) ka falur 8 ose 10 rekate gjatë netëve të Ramazanit. Nisur nga kjo, ndërkohë që një pjesë e dijetarëve kanë arritur në konkluzionin, që Profeti (a.s) ka falur gjithsej 8 rekate teravi, pjesa më e madhe janë të mendimit, që këto 8 ose 10 rekate janë namazi i natës që Ai (a.s) ka falur vazhdimisht edhe jashtë Ramazanit, si një namaz i detyrueshëm për të. Prandaj për përcaktimin e numrit të rekateve të teravive kanë marrë për bazë disa transmetime të tjera (Ibn Ebi Shejbe, el-Musannef, 2/164 [7692]; Bejhaki, es-Sunen el-kubra, 2/698 [4286]) dhe sidomos praktikën e Omerit (r.a), ku numri i këtyre rekateve është 20. Kjo është konsideruar si ixhma e sahabëve, të cilët nuk e kanë kundërshtuar veprimin e Omerit (r.a). Që nga atëherë shumica e besimtarëve kanë falur 20 rekate me xhemat. Sepse, nëse numri i rekateve të teravive nuk do të ishte ky, Omeri (r.a) s'ka se si të urdhëronte një namaz uniform në 20 rekate.

21. Si falet namazi i vitrit me xhemat?

Namazi i vitrit falet me xhemat vetëm gjatë muajit Ramazan. Praktikisht xhemati bën nijet pas imamit si çdo namaz tjetër që falet në kolektiv. Pastaj ndjek hap pas hapi veprimet e tij. Diferenca këtu mund të jetë në numrin e rekateve ose në bërjen e duasë së kunutit. Hanefitë e falin vitrin në 3 rekate me një salam dhe s'mund ta falin më shkurt apo të ndara në 2+1.

Një praktikë tjetër e lejuar në medhhebet e tjerë është që falet në 3 rekate e ndarë 2+1 ose vetëm një rekat. Këto dy të fundit janë të pavlefshme për hanefitë, prandaj nëse imami vepron kështu, atëherë xhematliu mund të falet me imamin dhe pastaj të falë 3 rekate vitrin si në Medhhebin Hanefi.

Nëse imami fal 3 rekate bashkë dhe bën duanë e kunutit që di vetë, atëherë edhe sipas hanefive namazi i vitrit është i kryer dhe s'ka nevojë ta falë përsëri.

22. Si bëhet Duaja e Kunutit nëse imami vepron ndryshe nga forma që ne veprojmë?

Duaja e Kunutit tek hanefitë bëhet pa zë dhe pa ngritur duart. Imami dhe xhemati e bëjnë secili më vete. Por nëse imami nuk është hanefi, e fal vitrin me 3 rekate pa i ndarë dhe e bën duanë me zë dhe me duar të ngritura, xhematliu hanefi ndjek imamin dhe gjatë duasë lejohet t'i ngrejë duart ose t'i mbajë ulur.

Parimet e Edukimit Profetik: “Lehtësoni, mos vështirësoni”



Një nga parimet themelore të edukimit profetik është edhe parimi “Lehtësoni, mos vështirësoni”. I Dërguari i Allahut deklaroi në raste të ndryshme se ky kriter duhet të merret si bazë në arsim dhe urdhëroi: “Lehtësoni, mos vështirësoni”.¹ Në këtë hadith, ku Ai përmbledh filozofinë e arsimit dhe edukimit, ai theksoi edhe të kundërtën e kësaj medtode që kuptohet më mirë. Sepse, gjithçka dihet dhe kuptohet më së miri me të kundërtën e saj. Nëse Ai do të thoshte thjesht “Lehtësoni!”, do të kuptohej që në këtë parim bën pjesë edhe lehtësia e herëpashershme dhe braktisja. Prandaj, duke përmendur lehtësinë dhe të kundërtën vështirësinë, Ai thekson se komoditeti duhet të merret si bazë në çdo gjendje dhe situatë.

Në fakt, truri i njeriut dhe psikologjia e tij janë krijuar me një prirje për të lehtë. Kjo është arsyeja pse shpirti nuk dëshiron të ndërmarrë përgjegjësi të vështira dhe shpesh bën justifikime dhe i shmanget asaj. Aisha (r.a) thotë: “Kur Ai duhej të zgjidhte midis dy gjërave, Ai patjetër do të preferonte më të lehtëën, me kusht që të mos kishte

1. Buharî, Ilim 11, Edeb 80, Xhihad 164.

mëkat. Nëse ishte një mëkat i lehtë, Ai ishte njeriu më i largët i atij mëkati.”² Ajo na tregon se i Dërguari i Allahut gjithmonë e ka zbatuar këtë parim në jetën e Tij.

I Dërguari i Allahut e mori këtë parim si bazë në edukim dhe i këshilloi shokët e tij të veprojnë sipas këtij kriteri në çdo rast. Një nga shembujt më goditës që shpreh këtë fakt është incidenti i mëposhtëm në Mesxhidin e Profetit:

Ndërsa Profeti ishte në xhaminë e tij, një beduin erdhi, fali dy rekate dhe pastaj u lut si më poshtë: “O Allah! Ki mëshirë për mua dhe Muhamedin dhe mos ki mëshirë për askënd tjetër veç nesh!” Kur dëgjon lutjen, Profeti ynë i kthehet bedunit dhe i thotë: “Ju e ngushtuat atë që është shumë të gjerë!” Pas pak, i njëjti person ngrihet dhe tërhiqet në një cep të xhamisë dhe fillon të kryejë nevojat e tij. Ata që ishin dëshmitarë të incidentit shkojnë menjëherë drejt tij dhe përpiqen ta parandalojnë atë. Kur e kuptoi situatën, i Dërguari i Allahut tha: “Lëreni atë, mos e shqetësoni!”. Kur burri mbaroi, Ai u tha të pranishmëve: “Tani çohuni dhe derdhni një kovë me ujë atje ku urinoi. Ju

2. Buharî, Menâkib 23.

u dërguat si lehtësues, jo si ndërlikues". Pastaj e thirri beduinin në krah dhe i tha në një mënyrë të qetë dhe të butë, "Mesxhidet nuk janë vende të përshtatshme për urinim. Sepse këto janë vendet e caktuara vetëm për adhurim, lutje dhe leximin e Kuranit".³

Me rastin e këtij incidenti, i Dërguari i Allahut u kujtoi shokëve të tij parimin e "lehtësimit" në arsim dhe e kishin për detyrë ta përhapnin këtë parim. Përveç kësaj, Ai e kujton këtë parim gjatë dërgimit të shokëve të tij në vende të ndryshme si mësues, zyrtarë dhe administratorë, Ai i këshilloi ata që të jenë të kujdesshëm.⁴

Duke miratuar parimin e "lehtësoni dhe mos vështirësoni" në arsim, i Dërguari i Allahut paraqiti disa parime për ta arritur këtë:

Mos u nxehtë

Një nga parimet që duhet të respektohet për të lehtësuar arsimimin është edhe kontrollimi i nxehtësisë. Sepse, atyre që u afrohen me nerva, i shmangen arsimit dhe mësuesit. Në këtë kuptim, nxehtëja nuk ka asgjë për të sjellë në arsim.⁵ Prandaj, i Dërguari i Allahut thotë tre herë radhazi: "Mësojeni dijen dhe lehtësoni, asnjëherë mos vështirësoni!". Më pas thotë dy herë: "Nëse jeni të nxehtë, qetësohuni dhe heshtni".⁶

Të kihet parasysh gradualizmi

Një nga shtyllat e lehtësimit në arsimin dhe edukimin është gradualizmi. Gradualizmi do të thotë të mësosh njerëzit me diçka gradualisht, të përparosh hap pas hapi dhe të lëvizësh gradualisht në një distancë. Ashtu si aftësitë e tjera të njeriut, mendja e tij është gjithashtu e kufizuar. Prandaj, ajo nuk mund të perceptojë dhe kuptojë gjithçka menjëherë. I Dërguari i Allahut e bëri më të lehtë mësimin e Islamit duke vepruar gradualisht në edukimin dhe trajnimin e sahabëve. Xhondub Ibn-i Abdillahi rrëfen: "Një grup të rinjsh po merrnin mësim nga Profeti ynë. Para se të fillonin të mësonin Kuranin, ata morën mësim mbi besimin. Pastaj ne filluan të mësonin Kur'anin. Ndërsa mësonin Kuranin, besimi i tyre u rrit edhe më shumë."⁷

Të kihet parasysh niveli

Një nga kushtet e parimit të "lehtësimit dhe

mos vështirësimit" në arsim dhe edukim është të merret parasysh zhvillimi shoqëror, psikologjik dhe fiziko-emocional i bashkëbiseduesve, si dhe nivelet e tyre mendore, të kujtesës, arsytimit dhe perceptimit. Sepse, ndryshimi në nivelin midis individëve është një realitet që nuk mund të injorohet dhe fusha që duhet kushtuar më shumë vëmendje në këtë çështje është edukimi. I Dërguari i Allahut tha: "Ne, bashkësia e profetëve, gjithmonë jemi urdhëruar të zbresim në nivelin e njerëzve dhe të flasim në një mënyrë që ata të kuptojnë".⁸

Zgjedhja e kohës më të përshtatshme

Një disiplinë themelore që rezultoi në lehtësimin në arsim dhe edukim është edhe përcaktimi i kohës më të përshtatshme për bisedë dhe mësim. Edukimi për t'u dhënë në një kohë kur bashkëbiseduesit janë shumë të lodhur, ngurrojnë dhe kanë nevojë për pushim dhe kur mendjet janë shumë të zëna ose të paorganizuara nuk do të jetë shumë efektive. Në të vërtetë, Abdullah Ibn Mes'ud, një nga dishepujt më të afërt të Profetit, tha: "Kur Profeti (salallahu alejhi ue selem) dëshironte të predikonte dhe të këshillonte, Ai shikonte situatën tonë në mënyrë që Ai të mos ndjehej i mërzitur me ne dhe ai përcaktonte kohën më të përshtatshme për të."⁹ Përsëri, herë pas here, ai i shtynte përgjigjet e pyetjeve që i ishin bërë, pastaj thërriste personin përkatës tek ai dhe i përgjigjej pyetjes së tij. Ai e përdori këtë si një metodë që bashkëbiseduesi të mbledhte mendjen dhe vëmendjen e tij të çrregullt dhe të mësonte përmendësh më mirë atë që do të thoshte.

Mësimdhënie praktike

Një nga mënyrat për ta bërë më të lehtë mësimdhënien dhe edukimin është të tregosh atë që thuhet në praktikë. Në këtë aspekt, arsimi i aplikuar ka një vend të rëndësishëm në procesin e bartjes së informacionit të mësuar në jetë dhe transformimin e tij në sjellje. Në fakt, arsimimi dhe edukimi i të kuptuarit të të Dërguarit të Allahut zakonisht bazohet në këtë metodë. Ai së pari jetoi dhe zbatoi ajetet që iu dërguan, pastaj predikoi ato dhe madje i tregoi praktikisht. Në këtë kuptim, edukimi i tij nuk ka të bëjë vetëm me teori dhe sugjerime. Për shembull, pasi ai e shpjegoi namazin me të gjitha detajet e tij, Ai u tha shokëve të tij: "Kryeni faljet tuaja siç bëra unë."¹⁰

3. Buharî, Vudu' 58; Ebu Davud, Taharet 13.

4. Muslim, Xhihad 6; Ebu Davud, Edeb 20.

5. Çështja e disiplinës dhe autoritetit, nga ana tjetër, është një çështje e veçantë që duhet të trajtohet, përveç çështjes së zemërimit.

6. Bukhari, Edebu'l-Mufred, fq. 68 (245); Ahmed Ibn Hanbal, Musnad, I / 239 (2136, 2556); Hejthemî, Zeuâid, VIII / 7.

7. Ibn Mâxhe, Sunnet 9 (61); Bejhâkî, Sunenu'l-Kubra (5498).

8. Sehauî, el-Makâsidu'l-Hasene, s. 120; Zebidî, İthafu's-Sâde, II/65.

9. Tirmidhî, Edeb 72 (2855).

10. Buharî, Ezan 18.

Ballafaqimi me sfidat mendore dhe emocionale

Besimtarë të nderuar!

Në në një botë që ndryshon me ritme të shpejta, sfidat mendore dhe emocionale si stresi, ankthi dhe depresioni janë bërë pjesë e përditshmërisë për shumë individë, përfshirë edhe të rinjtë. Feja mundëson një perspektivë unike për përballimin e këtyre sfidave, duke ofruar qetësi shpirtërore, shpresë dhe udhëzim në çdo rast.

Stresi është një përgjigje normale ndaj presionit të jashtëm, por kur është i tepruar, mund të ndikojë në shëndetin fizik dhe mendor të njeriut.

Nga ana tjetër, ankthi është një ndjenjë frike ose pasigurie për të ardhmen.

Ndërsa depresioni karakterizohet nga një ndjenjë e thellë trishtimi dhe mungese motivimi.

Feja na mëson të pranojmë dobësitë tona dhe të kërkojmë ndihmë, fillimisht nga Zoti, e më pas sipas rrethanave, edhe nga njerëzit që na rrethojnë.

Në Kur'an dhe tekste të tjera fetare, sfidat e jetës kalojnë si sprova për të testuar forcën e karakterit dhe besimit.

Këto sprova janë një mundësi për të reflektuar dhe për t'u afruar më shumë me Zotin.

Feja na mëson të jemi optimistë ndërsa lutja është një formë komunikimi me Zotin, që sjell qetësi dhe mbështetje shpirtërore:



“Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut” (Surja 13:28)

Falenderimi i Zotit për mirësitë që na ka dhuruar na ndihmon të zhvendosim fokusin nga negativja drejt mirënjohjes.

Kryerja e adhurimeve si falja e namazit, leximi i Kur’anit, agjërimi, etj, ndihmojnë në qetësimin e mendjes.

Historitë e profetëve dhe personaliteteve të shquara fetare që përballuan sfida të mëdha janë shembuj frymëzues për të mos humbur shpresën.

Feja inkurajon përfshirjen në aktivitete të dobishme dhe ruajtjen e disiplinës për të përmirësuar gjendjen emocionale dhe mendore.

Feja nuk e përjashton kërkimin e ndihmës profesionale, si terapia psikologjike apo këshillimi, por e përforcon atë me qasjen shpirtërore.

Kombinimi i ndihmës profesionale dhe përkushtimit fetar ofron një qasje të plotë për të përmirësuar shëndetin mendor.

Ballafaqimi me stresin, ankthin dhe depresionin është një proces që kërkon durim, përkushtim dhe mbështetje. Feja na mëson se sprovat janë pjesë e jetës dhe se përmes lutjes, shpresës dhe bashkëpunimit me të tjerët, mund të arrijmë një mirëqenie më të plotë mendore dhe shpirtërore.

DOBITË SHËNDETSORE TË AGJËRIMIT

Intervistë me mjekun Enver Bami

Pyetje: Profeti Muhamed (a.s.) në një hadith, thotë: "Agjëroni që të jeni të shëndetshëm." Si mund ta kuptojmë këtë hadith në aspektin mjekësor?

Agjërimi mund të quhet një terapi mjekësore, e cila ka dobi për shëndetin fizik dhe atë mendor. Agjërimi gjatë muajit të Ramazanit mund të sjellë shumë përfitime në aspektin e shëndetit fizik dhe mendor tek njeriu dhe këto përfitime mund të jenë si menaxhimi i peshës trupore, ruajtja e një metabolizmi të ekuilibruar dhe kontroll më i mirë i niveleve të sheqerit në gjak.

Duke respektuar agjërimin gjatë ditës, trupi merr pushim nga tretja e vazhdueshme, gjë që mund të ndihmojë në përmirësimin e funksionit metabolik dhe promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së përgjithshme. Të gjithë dëgjojmë nga mjekët apo dietologët për dieta të ndryshme, por mund të them që nuk ka dietë më të mirë se sa agjërimi. Agjërimi të rrit përqendrimin, vëmendjen, të bën të ndjehesh me i lehte në trup e gjithashtu, krahas kësaj, si pastrim dhe ndryshim tërësisht të trupit vërehet edhe rënia në peshë.

Pyetje: Mjekësia bashkëkohore ka dëshmuar me studime të hollësishme se agjërimi ka shumë dobi shëndetësore; çfarë mund të na thoni rreth kësaj çështjeje?

Po, është e vërtetë. Studimet e bëra ndër vite rreth agjërimin, por edhe ato më të fundit vazhdojnë të vërtetojnë fjalët dhe këshillat profetike, si edhe argumentet janë bërë tashmë të qarta edhe për arsyen apo urtësinë përse Zoti e ka bërë detyrim se paku një muaj në vit, krahas pëlqimit të agjërimin vullnetar.

Së pari, agjërimi përmirëson metabolizmin dhe kontrollin e peshës, rrit ndjeshmërinë ndaj insulinës, duke bërë që kjo gjë të çojë në uljen e sheqerit në gjak e automatikisht ndihmon në uljen e peshës. Kur një person agjëron, trupi detyrohet të përdorë glukozën e ruajtur për energji, që ndihmon në uljen e nivelit të sheqerit në gjak. Agjërimi mund të ndihmojë gjithashtu në uljen e inflamacionit në trup, i cili është një faktor kontribues në rezistencën ndaj insulinës. Përveç kësaj, agjërimi mund të ndihmojë në promovimin e humbjes së peshës, e cila është e rëndësishme për kontrollin e niveleve të sheqerit në gjak, pasi yndyra e tepërt e trupit mund të çojë në rezistencë ndaj insulinës dhe nivele të larta të sheqerit në gjak.

Gjithashtu, dallohet përfitimi që i bën sistemit kardiovaskular, ku ka plot studime që tregojnë se agjërimi çon në uljen e tensionit, të yndyrnave, të inflamacionit, të cilat në tërësi janë faktorë kyç në sëmundjet kardiovaskulare.

Një nga përfitimet e rëndësishme të agjërimin në Ramazan është se forcon



sistemin imunitar. Gjatë një agjërimi, trupi kalon nga përdorimi i glukozës si burimi kryesor i energjisë në përdorimin e ketoneve, të cilat prodhohen nga rezervat e yndyrës. Ky ndryshim aktivizon një proces të quajtur autofagji, ku trupi fillon të shpërbëjë dhe riciklojë qelizat e dëmtuara, duke përfshirë ato në sistemin imunitar. Autofagjia ndihmon në përmirësimin e funksionit të sistemit imunitar, duke hequr qelizat immune të vjetra ose të dëmtuara dhe duke i zëvendësuar ato me të reja, të shëndetshme.

Studimet kanë zbuluar se agjërimi stimulon një proces qelizor të quajtur autofagi, nëpërmjet të cilit qelizat pastrohen nga elementet e dëmtuara.

Gjithashtu agjërimi ndihmon në rritjen e funksionit të trurit dhe është faktor mbrojtës ndaj sëmundjeve neurodegenerative.

Pyetje: Është një pyetje që bëhet shpesh dhe u drejtohet rëndom specialistëve të shëndetit: A mund të mbajnë agjërim të sëmurët diabetikë?

Përsa u përket diabetikëve, ato ndahen në disa lloje: diabet i tipit 1 dhe i tipit 2. Tek diabetikët tip 1 mund të ndodhë që të kenë shpesh luhatje të nivelit të sheqerit në gjak, vlera të larta ose të ulëta, dhe për këta persona është e nevojshme konsultimi paraprak me mjekun përgjegjës nëse mund të jenë në gjendje të agjerojnë apo jo. Ndërsa në diabetin tip 2, zakonisht nivelet e sheqerit në gjak janë të qëndrueshme, por nëse do agjërojmë duke patur këtë diagnozë, përsëri

do duhet të konsultohemi me mjekun për të rregulluar nivelet e marrjes së insulinës. Duhet patur kujdes në menyrën e të ushqyerit, shmangien e ushqimeve që kanë sheqer.

Pyetje: Mund të na jepni disa këshilla në lidhje me shëndetin në muajin e Ramazanit?

Sigurisht që teologët janë më të saktë në dhënien e këshillave përsa u përket rëndësisë që ka në anën e brendshme agjërimin, shpërbërimit që ka tek Zoti si edhe sinjoretin e punës për të fituar kënaqësinë e Zotit. Ajo që mund të them në planin individual dhe në aspektin e jashtëm jetësor të agjërimin, është se, në radhë të parë, nëse do të disiplinosh veten, agjëro. Nëse do të jesh i shëndetshëm, agjëro. Nëse do të ndalosh një ves, agjëro. Nëse ke nevojë për terapi mjekësore apo psikologjike, agjëro.

Gjatë muajit të Ramazanit duhet patur kujdes për t'u hidratuar në periudhat kohore të lejuara, domethënë, konsumimi i ujit në syfyr dhe në iftar në sasi 2 litra e sipër. Shmangia e pijeve me gaz e sheqer, ushqimeve të skuqura e atyre që përmbajnë sheqer.

Gjatë ditëve të para është prezente dhimbja e kokës prej mungesës së kafes apo edhe mungesës së ushqimit, gjë që do të kalojë sapo trupi dhe truri të mësohet me sistemin e ri.

Lusim Zotin që të na begatojë më mirësitë e agjërimin dhe të na bëjë të përfitojmë nga dobitë fizike por edhe ato shpirtërore.

Muaji Shaban dhe *Nata e beraetit*

Në fenë Islame disa periudha kohore janë më të veçanta sesa të tjerat. Këtë ne e konstatojmë në Kur'an dhe në Traditën Profetike ku shohim që agjërimi dhe leximi i Kur'anit në muajin e Ramazanit, adhurimi në një të tretën e fundit të natës, lutja që bëhet menjëherë pas faljes së namazeve farz dhe shumë raste të ngjashme na tregojnë për vlerën e veçantë të disa kohëve të caktuara. Përcaktimi i këtyre kohëve të veçanta është një vlerësim, të cilin mund ta bëjë vetëm Kur'ani ose Tradita Profetike. Në këtë aspekt, muaji Sha'ban, së bashku me natën e mirë beraet, janë konsideruar si kohë me vlera të veçanta që duhen shfrytëzuar me adhurim. Imam Ahmed b. Hanbeli na transmeton se Usame b. Zejdi r.a. i rrëfen Profetit a.s. një konstatim: "S'të kam parë të agjërosh në asnjë muaj, aq sa agjëron gjatë muajit shaban. I Dërguari i Allahut a.s. i tregon: "Ky është një muaj i cili nuk vlerësohet ashtu siç duhet nga njerëzit. Në muajin shaban veprat lartësohen për tek Allahu xh.xh. dhe mua më pëlqen të jem në agjërim ndërkohë që ato ngjiten atje". Nëse do të lindte pyetja se cili agjërim është më me vlerë, ai në muajt haram apo në muajin shaban, përgjigjen e kësaj na e jep hadithi i Enes b. Mâlikut r.a. i transmetuar nga Tirmidhiu, ku thuhet: U pyet Profeti a.s. se cili agjërim është më me vlerë pas atij të ramazanit dhe ai u përgjigj: "Muaji shaban, duke lartësuar kështu ramazanin". Tirmidhiu përsëri nga Aishja r.a. transmeton hadithin vijues:

"Nuk e kam parë Profetin a.s. të agjërojë aq shumë sa në muajin shaban. E agjëronte thuajse të gjithin pa pak ditë. Thuaj që e agjëronte të gjithin". Në një hadith të dobët Aishja r.a. përcillet: Profeti a.s. agjëronte më tepër në muajin shaban prandaj e pyeta: "O i Dërguar i Allahut, shoh që agjëron më tepër në muajin shaban?" Dhe ai m'u përgjigj kështu: "Në këtë muaj përcaktohen emrat e njerëzve që engjëlli i vdekjes do të marrë dhe më pëlqen

të jem agjërueshëm, ndërkohë që emri im regjistrohet te kjo listë". Këtë informacion e mbështet një tjetër hadith që është mursal ku thuhet: "Exhelet përcaktohen çdo shaban. Madje ndoshta një person mund të martohet dhe të bëhet baba, ndërkohë që emri i tij është shkruar mes të vdekurve". Dhe kur hyn muaji shaban, duke pasur parasysh që është si një parapritje për muajin e ardhshëm, lejohet çdo adhurim që bëhet në muajin ramazan, si agjërimi dhe leximi i Kur'anit, në mënyrë që besimtari të përgatitet për adhurimet farz. Seleme b. Kuhejl r.a. thoshte kështu kur hynte muaji shaban: "Ky është muaji i lexuesve të Kur'anit". Shprehet kështu sepse gjatë këtij muaji njerëzit nisin leximin e Kur'anit, përpara se të hynin në ramazan. Si shkak për të bërë më tepër adhurim në muajin shaban në fakt është i mjaftueshëm hadithi në të cilin Profeti a.s. na tregon se "ky është një muaj i cili nuk vlerësohet ashtu siç duhet nga njerëzit", sepse adhurimi në një kohë që njerëzit merren me punë të tjera e bën më me vlerë atë.

Nata e Beraetit

Imam Ebû Tâlib el-Mekkî kur radhit netët e mira, sipas të cilit gjithsej ato janë 15, tregon që është e pëlqyeshme (mustehab) që edhe nata e mesit në muajin shaban (nata e beraetit), të kalohet me adhurime të ndryshme. Në të njëjtën kohë ai thekson që njerëzit e kishin zakon që gjatë këtyre netëve të falnin 100 rekate namaz duke lexuar në secilin rekat 10 herë suren Ihlâs. Këto qusheshin netët e hajrit (mirësisë). Madje grumbulloheshin edhe në xhamia për të përfituar nga begatia e tyre duke u falur me xhemat. Hasan Basrî dëshmon që ka dëgjuar nga 30 sahabe, që kush fal këtë namaz në këtë natë, Allahu e sheh atë 70 herë. Në secilin shikim i plotëson atij 70 nevoja, ndër të cilat më e vogla është falja. Sipas një transmetimi, kjo është nata rreth së cilës Allahu ka thënë kështu në Kur'an: "Në të



përcaktohen të gjitha punët me urtësi” (Duhân, 44:4). Por sipas mendimit të Ibn Rexhebit në këtë ajet bëhet fjalë për Natën e Kadrit. Ky namaz, i cili është transmetuar nga të parët tanë, ndër të cilët edhe imam Gazaliu, falet natën e 15 të këtij muaji. Falen 100 rekate me një selam në çdo dy rekate. Në çdo rekat lexon 11 herë suren Ihlâs pas sures Fâtiha. Ose mund të falen 10 rekate duke lexuar në çdo rekat 100 herë suren Ihlâs pas sures Fâtiha. Nga Ibn Abbâsi r.a. transmetohet që Allahu Teala përcakton kaderin natën e mesit të muajit shaban (nata e beraetit) dhe ia dorëzon atë përgjegjësve Natën e Kadrit. Kjo natë është quajtur nata e begatë, si në ajetin e katërt të sures Duhan, nata e beraetit, nata e marrëveshjes, nata e mëshirës, etj., sepse këtë natë Allahu përcakton falje për robërit e Tij. Gjithashtu transmetohet se Allahu i bën të ditur engjëjve të gjitha ndodhitë dhe dukuritë e vitit në vijim, dhe këto shkruhen në Leuhin Mahfudh. Nga një fletë i dorëzohet engjëjve. Mikâilit, fleta e furnizimit vjetor, Xhibrilit, fleta e luftërave, Azrâilit, fleta e exhelit e kështu me radhë. Ibn Tejmiije thekson se nata e beraetit është e veçantë dhe ka vlera shpirtërore. Këtë na e dëshmojnë hadithet që janë transmetuar në lidhje me të. Ka prej selefëve që faleshin enkas këtë natë. Ky është një fakt që nuk duhet mohuar. Megjithëse namazi i posaçëm me 100 rekate dhe grumbullimi nëpër xhamia për këtë natë nuk është transmetuar në traditën profetike, nuk ka asgjë të keqe nëse njerëzit, si ne, që kanë nevojë të edukohen me adhurim, shkojnë në xhami për të falur disa rekate namaz suplementare duke besuar në vlerën e kësaj nate. Kurse agjërimi në përgjithësi muajin e shabanit është i transmetuar, dhe besimtari mund të agjërojë ditën që paraprin natën e beraetit dhe ditën në vijim, që në fakt është këshilluar edhe në hadith. Ndërkohë që agjërimin e ditës së beraetit e përforcon edhe transmetimi i Ali b. Ebî Tâlib r.a. në koleksionin sunen të Ibn Mâxhes, ku thuhet: “Kur të vijë

mesi i muajit shaban, kalojeni natën me adhurim dhe ditën me agjërim. Sepse pas perëndimit të diellit Allahu xh.xh. zbret në qiellin më të afërt me tokën dhe deri në agimin e diellit Ai i drejtohet robërve të Tij duke u thënë: A ka ndonjë prej jush që kërkon falje e ta fal atë? A ka ndonjë që kërkon rizk (furnizim) e ta furnizoj atë? A ka ndonjë të sprovuar rëndë e ta shpëtoj atë? E kështu vazhdon “A ka ndonjë që kërkon këtë apo atë, etj., t’ia jap atij”. Ibn Mâxhe gjithashtu transmeton nga Ebû Mûsâ el-Esh’ari r.a. që Profeti a.s. ka thënë: “Allahu xh.xh. zbret natën e mesit të shabanit dhe i fal të gjitha krijesat e Tij përveç politeistëve dhe debatuesve”. Ahmed b. Hanbel transmeton nga Abdullah b. ‘Amri r.a. që Profeti a.s. ka thënë: “Allahu xh.xh. i drejtohet krijesave të Tij natën e mesit të shabanit dhe i fal të gjitha ato përveç dy, debatuesve dhe vrasësve”. Hadith të cilin Ibn Hibban e transmeton në gradën merfû’ nga Mu’adhi r.a. Transmetohet se kalifi Abdullah b. Abdulazîz i ka dërguar një letër mëkëmbësit të tij në Basra ku i thotë: Përkujdesu për katër netë në vit, sepse Allahu në to shpërndan mëshirën e Tij: natën e parë të rexhebit, natën e mesit të shabanit, natën e fitrit dhe natën e kurbanit. Imam Shâfiu gjithashtu e mbështet mendimin për natën e beraetit. Atâ b. Jesâr r.a. ka thënë: “Nuk di natë më të mirë se ajo e beraetit pas natës së Kadrit...” Për këtë arsye, besimtari duhet që këtë natë ta ndajë për të përmendur Allahun, për të kërkuar falje për mëkatet dhe që Allahu t’ia mbulojë ato, që ta shpëtojë prej problemeve, etj. Në krye të të gjithave duhet të jetë teubeja, kërkesa e faljes me pendesë, sepse Allahu xh.xh. fal të gjithë ata që kërkojnë falje në këtë natë. Me sa shohim në burimet e haditheve, plot transmetime të sakta dëshmojnë mirësinë e kësaj nate. Kështu që, nuk mbetet gjë tjetër veçse me përlulësi ndaj Krijuesit tonë të vazhdojmë adhurimet duke e paraprirë në formën më të përshtatshme Muajin e Madh të Ramazanit.

RAMAZANI PO NA THËRRET!



Muajii begatë i Ramazanit, është muajii mëshirës së pakufishme të Allahut (xh.sh.). Arsyeja përse e quajmë kështu, është për faktin e shpërblimeve të mëdha që besimtari fiton prej punës së tij të dedikuar me sinqeritet për Zotin e tij. Allahu (xh.sh.) duke dashur ta mëshirojë besimtarin dhe ta lartësojë në grada, ia ka bërë obligim agjërimin dhe nuk ia ka lënë atë si një punë të pëlqyeshme apo vullnetare. Duke qenë një urdhër i drejtpërdrejtë nga Zoti i botëve, atëherë askush prej besimtarëve që i përgjigjet me sinqeritet kësaj urdhërese, nuk do të humbasë mundësinë e madhe të fitimit të mëshirës së pakufishme të Zotit të tij.

Mëshira e Allahu (xh.sh.) padiskutim që është prezente çdo ditë të jetës tonë. Kushdo që troket me punë të mira tek dera e Tij e mëshirës, do ta gjej shpërblimin dhe pranimin e Tij. Në Kuranin Fisnik, Allahu (xh.sh.) thotë kështu: “Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish”. (Enam,160). Pra, ky shpërblim është specifik për çdo ditë normale dhe për çfarëdo pune të mirë që besimtari bën.

Mirëpo kur flasim për shpërblimin e muajit të begatë të Ramazanit, kjo gjë ndryshon tërësisht. Për këtë na vjen në ndihmë hadithi Kudsi, ku Allahu (xh.sh.) thotë: “Çdo punë e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit. Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të”. (Buhariu). Nga ky hadith kuptohet qartë se shpërblimi i agjëruarit është i papërcaktuar, duke nënkuptuar shpërblimin e madh dhe të pakufishëm që besimtari do të fitojë ditën e gjykimit nga ana e Allahut (xh.sh.).

Në suren En'am, në ajetin 54, Allahu i Lartësuar i drejtohet kështu profetit të tij të dashur:

“Kur të vijnë te ti ata që besojnë në shpalljet Tona, thuaju: “Paqja qoftë mbi ju!”. Zoti juaj ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën. Nëse dikush nga ju bën ndonjë vepër të keqe pa e ditur, e pastaj pendohet e përmirësohet, ai do ta gjejë Allahun Falës dhe Mëshirues”.

E ku më mirë se në muajin e Ramazanit do të merrte më tepër vlerë ky ajet fisnik. Në këtë muaj të begatë, në të cilin zemrat e mbushura me besim vrapojnë drejt kënaqësisë hyjnore, duke agjëruar dhe duke shtuar veprat e mira.

Muaji i Ramazanit është një thirrje e Zotit të lartësuar për mbarë besimtarët, për t'u ofruar atyre një ndihmesë shumë të madhe, dhe për t'u dhënë një mundësi të re, në mënyrë që të arrijnë horizontet e larta të devotshmërisë dhe përkushtimit.

Besimtari gjithmonë ka nevojë për ndihmën e Zotit. Këtë nevojë profeti Muhammed (a.s), do ta shprehë në një nga lutjet e tij të mrekullueshme, ku ai do lutej kështu: “O i Gjallë o i Përvetshëm (

ja Hajju ja Kajjum), mëshirën Tënde kërkoj. Më përmirëso mua në mënyrë të plotë dhe mos ma lër në dorë veten time qoftë dhe për një moment sa hap dhe mbyll sytë”. (Nesaiu, Sunen Kubra).

Me anë të kësaj lutjeje, mësojmë që t'i nënshtrohemi Allahut të Lartësuar në mënyrë të plotë, aq sa të mos të mendojmë kurrëse se jemi të aftë të rregullojmë vetet tona pa ndihmën e Tij. Nëse përmirësimin e veteve nuk do ta kishim prej mëshirës së Allahut të Lartësuar, atëherë kurrëse nuk do të kishim arritur të jemi qoftë dhe prej besimtarëve.

Në muajin e Ramazanit kjo lutje sikur arrin kulminacionin e pranimin të saj nga ana e Allahut të Lartësuar. Kjo sepse i gjithë muaji i Ramazanit nuk është gjë tjetër veçse një mundësi e artë e dhënë prej Zotit për të përmirësuar vetet tona. Le të mendojmë në këtë mënyrë: Gjatë gjithë vitit ne kemi ulje-ngritje në raport me Allahun e Lartësuar. Ndoshta jo gjithmonë jemi treguar korrekt ndaj urdhëresave të Tij, qoftë për ti zbatuar ato, apo dhe për të qëndruar larg ndalesave. Duke qenë në këto intervale ulje-ngritjeje, është shumë vështirë për besimtarin që të arrijë një devotshmëri të mirëfilltë. T'i shtojmë kësaj dhe armikun tonë të përditshëm, shejtanin e mallkuar, i cili është gjithmonë në gatishmëri për të na sulmuar në pikat më të dobta dhe për të na shkatërruar devotshmërinë duke na mbushur me gjynahe. Pikërisht mbas një situatë të tillë, vjen ndihma e Allahut të Lartësuar mbi besimtarët, duke u dhuruar atyre dhe një herë mundësinë për të përfutur muajin e faljes, mëshirës dhe muajin e përfitimit të devotshmërisë sublime.

Allahu thotë në Kur'anin Fisnik: “O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat (të jeni të devotshëm)” (Bekare, 183)

Allahu (xh.sh.) dëshiron që besimtari të arrijë devotshmërinë. Për ta arritur këtë objektiv Allahu (xh.sh.) pikë së pari, ndihmën kryesore e jep duke dhënë mundësinë e agjërimit të muajit të Ramazanit. Kjo për arsye se gjatë vitit që ka kaluar shumë besimtarë të cilët i kemi njohur, ndoshta nuk janë më midis nesh. Apo sa besimtarë të cilët ne i njohim nuk mund të agjerojnë dot, sepse janë të sprovuar në shëndetin e tyre.

Së dyti, ndihma që na jep Allahu (xh.sh.) kundrejt armikut të përbetuar, shejtanit të mallkuar. Thotë Profeti Muhamed (a.s.): “Në muajin e Ramazanit prangosen shejtanët, mbyllën dyert e Xhehenemit dhe hapen dyert e Xhenetit”, (Buhariu). Pra, përgjatë një muaji, armiku i përbetuar të lë të qetë drejt rrugës së devotshmërisë.

Së treti, është inkurajimi dhe shpresa e madhe në zemër që fiton besimtari në këtë muaj si shkak i shpërblimit të madh që ka ky adhurim.

Për të kuptuar vlerën, madhështinë, shpresën, ndihmën dhe optimizmin e madh që fiton besimtari në këtë muaj si dhuratë prej Allahut të Lartësuar, na vjen në ndihmë kjo ngjarje kaq e bukur që ka ndodhur në kohën e Profetit Muhamed (a.s.). Talha bin Ubejdullah tregon se dy persona u bënë muslimanë në të njëjtën kohë. Njëri nga këta të dy ishte më shumë i dhënë pas fesë se sa tjetri, aq sa mori pjesë në një ekspeditë luftareke bashkë me profetin Muhamed (a.s.), dhe qe e shkruar që të binte dëshmor, ndërsa tjetri ndërroi jetë në kushte normale pas një viti. Pas pak kohësh Talhaja (r.a.) i shikon të dy në ëndërr, ku së bashku me ta shikon dhe veten e tij në hyrjen e portave të Xhenetit. Ai tregon se roja i Xhenetit thërret të parin për t'u futur në Xhenet, personin i cili vdiq në kushte normale një vit më vonë. Mbas pak kohësh vjen përsëri dhe thërret në Xhenet dëshmorin. Ndërsa kur vjen herën e tretë mua më tha që të kthehem se ke ende kohë. Pasi zgjohet në mëngjes, Talha ibn Ubejdullah shkon në xhami dhe ja tregon ëndrrën profetit Muhamed (a.s.), ku çudia më e madhe ishte se si ka mundësi që ky person që vdiq në kushte normale ja kaloi shehidit dhe u fut para tij në Xhenet?! Profeti Muhamed (a.s.) i përgjigjet duke i thënë se nuk ka asgjë për t'u çuditur me këtë situatë. Ai i pyeti të pranishmit:

-A jetoj një vit më shumë?, -Po i thanë të pranishmit.

-Gjatë këtij viti a ka falur kaq e kaq namaze, a ka bërë kaq e kaq sexhde?

-Po iu përgjigjën ata.

-Gjatë këtij viti a e ka arritur dhe agjëruar muajin e ramazanit? -Po i thanë ata.

Atëherë profeti Muhamed (a.s.) vazhdoi e tha: "Distanca midis atyre të dyve është sa distanca midis qiellit dhe tokës, duke treguar kështu se sa grada të larta mund të fitojë njeriu përgjatë një viti, sidomos kur arrin muajin e Ramazanit dhe e agjëron atë. (. Musned, 1/163; Ibn Maxhe, Tabir 10, no: 3925).

Të meditojmë pak gjithashtu mbi tre hadithet shpresëplotë që Muhamedi (a.s.) na ka thënë mbi muajin e Ramazanit duke i dhënë vlerë të madhe agjërimit dhe sexhdeve të shumta që bëhen gjatë këtij muaji.

"Kush e agjëron Ramazanin me iman dhe shpresën e shpërblimit e ka vetëm nga Allahu, atij do t'i falen gjitha gjynahet e mëparshme". (Buhariu)

"Kush e fal namazin e teravive gjatë Ramazanitn me iman dhe shpresën e shpërblimit e ka vetëm nga Allahu, atij do t'i falen gjitha gjynahet e

mëparshme". (Buhariu)

"Kush e kalon me namaz natën e Kadrit me iman dhe shpresën e shpërblimit e ka vetëm nga Allahu, atij do t'i falen gjitha gjynahet e mëparshme". (Buhariu)

Gjithashtu, në një hadith tjetër, i dërguari i Allahut shprehet kështu: "I shkatërruar është ai i cili e arrin Ramazanin dhe nuk i falen gjynahet!". (Tirmidhiu)

E gjithë kjo shpresë e madhe, falje, mëshirë, devotshmëri dhe lartësim në grada të larta, është një melhem për zemrën e besimtarit musliman. Melhem ky që vjen me muajin e begatë të Ramazanit.



NDJESHMËRIA E SAHABËVE NË TË SHPREHUR



Rruga që ndiqet, mënyra se si merret për bazë dhe se si shprehet mendimi, ndienja, dija, përcaktimi dhe përvoja, quhet artikulum në të folur (Uslup). Çdokush ka artikulin e tij të veçantë në të folur. Mënyra e artikulimit shfaq nivelin e dijes, moralin, karakterin, filozofinë e jetës dhe botëkuptimin e personit. Artikulimi është po aq i rëndësishëm sa vetë mesazhi i dhënë në shkrim apo fjalim. Madje në shumicën e rasteve është aq ndikues tek lexuesi apo dëgjuesi sa që e lë pas mesazhin që përcjell. Për këtë arsye duhet treguar kujdes në të shkruar dhe në të folur dhe i duhet dhënë rëndësia e duhur mënyrës së artikulimit. Gjithmonë duhet patur parasysh koha, vendi dhe kushtet, duhet kujdes në mimikë dhe gjeste dhe njëkohësisht duhet t'i tregohet rëndësi e veçantë tonit të zërit dhe fjalëve të përzgjedhura.

Sahabet e nderuar të cilët ishin edukuar nga Rrasulullahu (s.a.s.) me edukatën hyjnore ishin shumë të kujdesshëm në çdo aspekt. Mundoheshin që çdo punë ta kryenin brënda kornizës në lidhjen e tyre me Allahun, me bindjen ndaj të dërguarit të Tij dhe marrëdhënieve me të tjerët. Kjo ndikonte në gjendjen e tyre, përpjekjen dhe mundin që tregonin; ndikonte në ndienjat dhe mendimet e tyre por njëkohësisht ndikonte edhe në mënyrën dhe artikulin e fjalës së thënë. Situatat me të cilat përballeshin ua shpjegonin njerëzve që kishin rreth vetes në mënyrë që edhe ata të përfitonin sa më shumë nga eksperiencat e tyre. Këtë e bënin duke treguar një kujdes të veçantë dhe kjo ndikonte edhe në artikulin e tyre. Nëse ngjarja më të cilën ishin përballur, ishte negative, pa përmendur emra të veçantë jepnin mesazhin e duhur. Në këtë mënyrë shpëtonin vetet nga përgojimi, nuk turpëronin personin i cili kishte rënë në gabim, nuk ofendonin miqtë dhe të afërmit e tij dhe parandalonin mendimet negative që mund t'u vinin të tjerëve në lidhje me atë person.

Pa dyshim se kjo ndjeshmëri tregon një shembull morali të marrë nga Kur'ani dhe i Dërguari i Zotit. Kur'ani dhe Rrasulullahu (s.a.s.), kur na njoftojnë mbi ndodhitë e popujve nuk qëndrojnë mbi emra konkretë por vënë theksin mbi gabimet e tyre. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.) donte të zgjidhte një problem apo të rregullonte një gabim, mendohej të mos përmendte askënd por thoshte: "Ç'po ndodh me ju që ju shikoj duke vepruar kështu..."¹ dhe e zgjidhte problemin pa ofenduar asnjërin prej atyre që e kishin atë gabim.

"Muhaxhiri i Ummu Kajsit"

Në periudhën e Hixhretit, një Mekas emigroi për në Medine për t'u martuar me një grua e cila quhej Ummu Kajs. Kur është pyetur i dërguari i Allahut (a.s.) nëse do të ketë sevapet e hixhretit ky njeri apo jo, Ai (a.s.) tha:

"Punët (veprat) janë sipas qëllimit (nijetit). Çdokush do të përfitojë atë që ka patur për qëllim. Kush emigron për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe të dërguarit të Tij, emigrimi tij është për Ata. Kush emigron për të përfituar diçka të kësaj bote ose për t'u martuar me dikë, emigrimi tij është për atë ç'ka synon."²

Shpjegimi i Rrasulullahut (a.s.) tregonte se kishte një problem tek nijeti dhe se duhej ndryshuar. Sahabët e nderuar të cilët nuk donin të ofendohej ai person edhe pse e dinin emrin e tij nuk e kanë përmendur por kanë përdorur termin "muhaxhiri i Ummu Kajsit."

"Një grua"

Një ditë Rrasulullahu (a.s.) kishte shkuar për vizitë në varreza, ndoshta për të vizituar miqtë e Tij. Ndërkohë, në atë moment kish parë një grua që qante me të madhe mbi

1. Ebu Davud, Edeb 5

2. Buhari, Bedu'l-Vahy 1; Muslim, İmare 155; Ebu Davud, Talak 11



varrin e të birit dhe përdorte fjalë të papërshtatëshme për besimin. Profeti (a.s.) ishte mërzhitur për gjendjen e gruas. Që afruar afër saj dhe kish dashur ta këshillonte. Por gruaja nuk e kishte njohur se kush ishte Ai dhe i kish thënë: "Hiqmu qafe, ti nuk e di (kupton) se çfarë më ka ndodhur mua". Pas kësaj, Pejgamberi i mëshirës ish larguar pa i thënë gjë tjetër. Më vonë të pranishmit e njoftuan gruan se Ai që dëshiroi të të këshillonte ishte i Dërguari Allahut (a.s.). Gruaja ishte prekur shumë nga kjo. Sepse kishte mërzhitur Rrasulullahun (a.s.) edhe pse pa vetëdije. Duhej që ta rikuperonte gabimin duke i kërkuar falje të singertë. Menjëherë sapo mori veten shkoi tek shtëpia e Tij. I kërkoj falje e turpëruar. Rrasulullahu (a.s.) e fali atë dhe në këtë kontekst i tha: "Durimi është ai që tregohet në momentin e goditjes."

Sahabët të cilët transmetojnë hadithin me në krye Enes ibni Malik (r.a.) nuk e përmendin emrin e kësaj gruajeje të shokuar nga ngjarja e rëndë por përdorin termin "një grua" në mënyrë që të mos paragjykohet ose ofendohet nga gabimi.³

"Një djalosh"

Një ditë kur Rasulullahu (a.s.) po bisedonte me shokët, në xhami hyri dikush dhe i afrohet Atij. Më pas me një zë të lartë sa që e dëgjonin dhe të tjerët që ndodheshin prezentë, thotë: "O i Dërguari i Allahut! Më jep leje të bëj zina (imoralitet)." Kjo kërkesë e papritur ndikon keq tek ata që ndodheshin përreth dhe filluan t'i bërtisnin dhe ta ofendonin. Ndërkoqë që Rrasulullahu (a.s.) e ruan qetësinë, i ndalon të tjerët të flasin dhe i kërkon djaloshit të ulet përballë Tij.

Dhe e pyet: "A dëshiron ti që të bëhët zina me nënën, vajzën, motrën, hallën dhe tezen tënde?"

Ai i thotë: "Ç'është ajo fjalë o i Dërguar i Allahut, sigurisht që

nuk dëshiroj"

Rrasulullahu (a.s.) i thotë: "Edhe njerëzit e tjerë nuk dëshirojnë të bëhet zina (imoralitet) me nënat, vajzat, motrat, hallat dhe tezet e tyre."

Më pas Rrasulullahu (a.s.) vendos dorën mbi gjoksin e tij dhe i lutet Allahut për të: "O Zoti im! Falja gabimin, pastroja zemrën dhe ruaja nderin."⁴ Djaloshi pasi bindet dhe qetësohet nga fjalët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), largohet.

Ebu Umame (r.a.) i cili transmeton këtë hadith, edhe pse e dinte emrin e tij, përdor termin "një djalosh". Në këtë mënyrë nuk ofendohet as ai dhe as pasardhësit e tij kur e dëgjojnë historinë e këtij djaloshi të ndershëm, të martuar nga vetë Rrasulullahu (a.s.) dhe për të cilin, kur ka rënë dëshmor, i Dërguari i Allahu (a.s.) ka thënë që "është humbja ime." Dhe në këtë mënyrë mjaftohet për ta përmendur si ndodhi për të nxjerr mësim.

Rezultati

I dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.) me mënyrën e të folurit, të komunikuarit dhe me sjelljen e Tij ka ndikuar shumë në mënyrën e jetesës së shokëve të Tij. Duke marrë shembull Atë, sahabet janë treguar shumë të kujdesshëm në zgjedhjen e fjalëve që transmetonin. Në këtë mënyrë, nuk është lënë mundësia të ofendohet askush dhe anjëri nuk është detyruar të mbajë mbi supe gabimet e të parëve të tyre që kishin bërë në shoqëri. Po ashtu, as transmetuesit dhe lexuesit e ngjarjeve nuk bëheshin pjesë e përgojimeve.

Duhet të jetë një kriter i fortë për çdonjërin prej nesh mënyra e të folurit, të shkruarit dhe sjelljes së këtyre njerëzve të dashur të Allahut, të cilët janë një busull orientuese për të gjithë myslimanët.

3. Buhari, Cenaiz 32, 43, Ahkam 11; Müslim, Cenaiz 14, 15

4. Ahmed ibn-i Hanbel, Musned 36/545 (22211)

ZOTI JUAJ KA THËNË

“M’U LUTNI MUA, SE DO T’JU PËRGJIGJEM!”



Jeta e njeriut është begati e Allahut dhe si e tillë është hapësirë e aktiviteteve të shumta shpirtërore nëpërmjet të cilave njeriu arrin nivelin më të lartë të lidhjes së tij me Krijuesin. Në këtë mënyrë ai gjendet afër mëshirës dhe faljes së Tij. Lutja e ngre besimtarin lart saqë i gjithë personaliteti i tij është i koncentruar në këtë lidhje, kështu që gjithçka udhëhiqet prej saj. Lutja është nevojë shpirtërore e besimtarit ku ai i drejtohet Krijuesit të Tij, kërkon aprovim dhe miratim të veprimtarisë shpirtërore dhe fizike që ai kryen në emër të Allahut.

Duaja - lutja është një veprimtari shpirtërore që lindi bashkë me njeriun. Nisur nga fakti se besimi është nevojë e domosdoshme në jetën shpirtërore të njeriut, si i tillë ai e shoqëroi njeriun prej ditëve të para të tij. Prandaj, duke mbajtur parasysh se lutja është pjesë përbërëse e besimit, atëherë atë e ndeshim gjatë tërë historisë tek të gjitha besimet, qofshin ato qiellore apo të shpikura nga vetë intuita e njeriut.

Me ardhjen e Islamit çështja e besimit definohet në mënyrë të plotë duke u bazuar në Kur'anin Famëlartë dhe në fjalët e Muhamedit a.s., pra definohet edhe fenomeni i lutjes duke u çliruar nga të gjitha format e deformuara dhe elementet e kota të shpikura nga intuita e njeriut. Në kontekstin islam lutja paraqet pjesën përbërëse të fesë, pra të çdo aktiviteti që kryhet në emër të Allahut.

Kur'ani e përmend lutjen si pjesë përbërëse të jetës së peygamberëve e njerëzve në përgjithësi dhe si ndjenjë e lidhjes së njeriut me Zotin. Kur'ani e nxit njeriun për lutje, që ajo të jetë pjesë e pandarë gjatë jetës. Allahu thotë: "Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit Tim, do të hyjnë në xhehenem të nënçmuar." (Gafir, 60)

"E kur robërit e mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen dhe le të më besojnë Mua." (Bekare, 186)

Ndërsa Muhamedi a.s. lutjen e llogarit si formë të veçantë adhurimi kur thotë: "Lutja është adhurim".

Islami e sheh lutjen si një aktivitet ndërlidhës mes njeriut dhe Allahut. Ajo është lidhje e pastër që buron nga niveli i

bindjes së njeriut ndaj Krijuesit, duke qenë i lirë nga fuqitë destruktive fizike dhe materiale.

Lutja është kthim drejt vetvetes, është gjendje e aktivitetit shpirtëror dhe intelektual për ripërtëritjen dhe ringjalljen e vetëdijes së besimtarit. Nisur nga kjo, lutja në Islam ka bazat e saj dhe formulën e saj pa të cilat nuk mund të jetë e pranuar. Për këtë Islami paraprakisht kërkon përgatitje dhe kushte të veçanta nga të cilat varet vërtetësia, e pastaj edhe efekti i saj në jetë.

Që lutja të jetë e pranuar kërkohet:

-T'i drejtohet vetëm Allahut pa asnjë ndërmjetësues, mbështetur në ajetet vijuese:

"Dhe përpos Allahut, mos lut Zot tjetër e të bëhesh prej të dënuarve." (Shuara, 213)

"Përveç Allahut, mos iu lut tjetërkujt nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm..." (Junus, 106)

-Të bëhet me qëllim të pastër dhe sinqeritet të plotë:

"Luteni Allahun me adhurim të sinqertë për Të..." (Gafir, 14)

-Të bëhet më përlulesi dhe përkushtim të plotë, duke ndjerë thellë paaftësinë ndaj fuqisë absolute të Allahut.

"Luteni Zotin tuaj përluleshëm e ngadalë! Njëmend Ai nuk i do ata që e teprojnë." (Araf, 55)

Pra, nga ajo që shihet nga ajetet e sipërcituar, lutja është veprim i një vetëdijeje të lartë që lidh tre pjesët kryesore të personalitetit të njeriut: zemrën, të menduarit dhe të shprehurit e tij. Ajo është ide dhe praktikë që zhvillon dhe kultivon te njeriu të menduarin e pastër ndaj Zotit, praktikë në përputhshmëri me porositë e Tij dhe konsekuencë në veprim. Pra, pa këto elemente nuk konsiderohet lutje, dhe si e tillë nuk gjen miratim tek Allahu.

Siç kuptohet, lutja nuk është teori e thatë dhe shterpë, nuk është formalitet apo diçka abstrakte, përkundrazi, është angazhim maksimal i potencialit shpirtëror të personalitetit të njeriut që drejtohet kah i madhi Zot dhe inspirohet nga praktika e njeriut në emër të Zotit për t'u kthyer përsëri në praktikë.

Për ta ilustruar më mirë, këtu po sjellim shembullin e njërit prej personaliteteve të njohur të historisë islame, Ibrahim bin

Ed'hemit. Ai ishte dijetar i madh dhe rob i ruajtur. Përveç kësaj, këshillat e tij ndikonin shumë në sjelljet e njerëzve, ndaj mori titullin "Tabibul kulub" - shëruesi i zemrave. Një ditë duke shëtitur nëpër rrugët e Basrës, rreth tij u tubuan shumë njerëz ku ndër të tjera e pyetën:

- O biri i Is'hakut! Allahu në librin e tij thotë: "...Më thirrni Mua që t'ju përgjigjem..." Mirëpo, lutjet tona nuk pranohen?

Atëherë Ibrahim i përgjigj:

- O popull i Basrës, si t'jua pranojë Allahu lutjet, ndërkohë që zemrat tuaja janë shkujdesura. Pastaj shtoi:

- E njihni Allahun, mirëpo nuk i zbatoni urdhrat e Tij.

- E lexoni Kur'anin Famëllartë, por nuk veproni sipas tij.

- Pohoni se shejtani është armiku juaj, mirëpo ju e nderoni dhe pëlqeni atë.

- Thoni se i përkisni umetit të Muhamedit a.s., mirëpo nuk punoni sipas fjalëve dhe rrugës së tij.

- Dëshironi xhenetin, mirëpo nuk punoni për të.

- Dëshironi të shpëtoni nga zjarri i xhehenemit, ndërsa e hidhni veten në të.

- Pranoni se vdekja është realitet, mirëpo nuk përgatiteni për të.

- Merreni me të metat e të tjerëve dhe harroni tuajat.

- Ushqeheni me begatitë e Allahut, por nuk e falënderoni Atë.

- I varrosni të vdekurit tuaj, por nga kjo nuk nxirrni mësim.

Nga sa u tha më lart kuptohet se duaja duhet të jetë përgatitje maksimale dhe angazhim maksimal i të gjitha potencialeve dhe aktivizimi i të gjitha aftësive të njeriut drejt arritjes së qëllimit të planifikuar. Vetëm atëherë mund të pritët pranimi i saj nga Allahu.

Lutja, si pjesë përbërëse e besimit, ka qenë gjithmonë aktivitet i rëndësishëm dhe pjesë e pandarë e jetës së njeriut. Ajo vazhdon të jetë e rëndësishme edhe sot e kësaj dite, në veçanti në kohën e modernizmit dhe dinamizmit bashkëkohor,

ku njeriu po largohet nga vlerat e mirëfillta humane dhe po ballafaqohet me probleme të mëdha shpirtërore dhe fizike. Sot njeriu bashkëkohor mendon për gjithçka, ndërsa për veten aspak. Prandaj bota përballet me dukuri shqetësuese si narkomania, prostitucioni, kumari, vetëvrasja, dhuna, kriminaliteti, etj. E gjitha kjo e bën edhe më aktual fenomenin fe, respektivisht kthimin e njeriut kah Allahu, besimi, respektivisht të drejtuarit Atij me lutje për udhëzim dhe falje.

Këtë e vërtetojnë edhe psikologët, etimologët dhe sociologët e kohës, të cilët pohojnë se besimi në Zot është qetësim shpirtëror dhe shërim psikologjik, si dhe ndjenjë e thellë e cila e ndihmon njeriun që në momentet më të vështira të gjejë prehje. Kur njeriu i drejtohet Allahut, në këtë moment ai kupton qëllimin e jetës, sheh pozicionin e vet, analizon veprimet e tij duke ndjerë thellë brenda vetes afërsinë dhe mbështetjen e Fuqiptotit.

Nëse e kuptojmë kështu lutjen, atëherë do të bindemi në praktikë se begatitë dhe vlerat e saj janë shumë të mëdha dhe të dobishme për njeriun dhe shoqërinë njerëzore në përgjithësi, bazuar në thënien e Muhamedit a.s., i cili thotë: "Nuk ka gjë më të vlefshme tek Allahu sesa lutja." (Tirmidhiu dhe Ibni Maxhe)

Pra, lutja është një rast i mirë për afrimin tonë me Allahun dhe njëherësh vendosmëri për të jetuar në përputhje me porositë e Tij, duke qenë të vetëdijshëm se mëshira dhe falja e të Fajfalësit është shumë e madhe.

Së fundi, e gjej me vend të citoj fjalët e një njeriu të devotshëm, i cili lutej kështu për veten:

"Zoti im, si mos të të lutem Ty, kur unë jam mëkatar.

Zoti im, si mos të të lutem Ty, kur Ti je Mëshirues e Falës?!" në bazë të fjalës së madhe të Allahut të Lartë, sepse dinakërinë e egos mund ta kuptojnë vetëm njerëzit shumë të mençur.



Cjendet burimi i Zemzemit



Nuri që i takonte Profetit tonë të Dashur ndriçonte në ballin e Abdulmutalibit. Edhe ai për hir të kësaj lartësie kishte arritur të ishte prijësi i Hashimive. Në saje të ëndrrave që kishte parë përgjatë tri netëve, ai gjeti pusin e zemzemit. Prijësit e Mekës, në atë kohë, donin që të ishin bashkëpunëtorë në gjetjen e këtij uji të bekuar. Abdulmutalibi nuk pranonte. Aty u zbuluan shumë thesare teksa gërmohej për gjetjen e ujit, prandaj mekasit kërkuan përsëri që të ishin ortakë në thesaret e gjetura, mirëpo gjyshi i Profetit tonë të Dashur nuk e pranoi as këtë herë kërkesën e tyre. Atëherë mekasit iu drejtuan Abdulmutalibit, i cili kishte vetëm një djalë:

- Ti e sheh se përveç djalit tënd, nuk ke askënd tjetër këtu me vete. Atëherë pse del kundër nesh? Betohemi në Zot, se po të duam, edhe mund të të rrahim.

- Ju po silleni kështu me mua ngase unë nuk kam shumë fëmijë. Po më turpëroni ngase nuk kam shumë fëmijë. Ja, ku po ju betohem, se nëse Allahu i Madh më jep dhjetë djem në të ardhmen, njërin prej tyre do ta flijoj për Allahun, - tha ai.

Pastaj Abdulmutalibiu u ofroi mekasve një sugjerim që do ta zgjidhte situatën pa kurrfarë zënke:

- Le ta ndajmë në dysh thesarin që kemi zbuluar.

- Ta zëmë se e ndamë. E pastaj? Ç'do të ndodhë? - pyetën mekasit.

- Gjysmën e thesarit le ta hedhim në short midis nesh dhe Qabes. Nëse fitojmë ne, atëherë ju do të hidhni short edhe një herë short me mua. Secili duhet të kënaqet me atë që do t'i bjerë për pjesë, - ia ktheu Abdulmutalibi.

- Betohemi në Zot se ti dhe një gjykim të drejtë. Eja të ikim e ta hedhim menjëherë shortin me Qaben, - thanë ata.

Më pas ata hodhën short në mes tyre me prijësit e Mekës. Sipas përfundimit, gjysmën e thesareve e mori Abdulmutalibi, ndërsa pjesa tjetër i takoi Qabes. Mekasit nuk morën asgjë prej shortit të hedhur. Madje ata përfunduan duke u zënë me njëri-tjetrin për shkak të pafatësisë së tyre. Këto ndodhi, veç të tjerash, e rritën akoma edhe më shumë reputacionin që gëzonte Abdulmutalibi.

Gazel

Mrrini Muji i ngjinimit, erdh sanxhaku i Sulltanit,
Largo duert prej buke, se erdh 'Mâide' sofra e xhanit!

Shpirti prej ndarjes përvidhet, dora e tabjatit lidhet,
Zemra e humbjes mposhtet, erdh ushtria e imanit!

Ushtria e atyne 've'l-'âdijât' vuni dorën me marrë krejt,
Prej flakëve të 'fe'l-mûrijât' nefsi erdh n'vaj t'pishmanit.

Lopa 'el-Bekare' sa e mirë, dul Musa i biri Imranit,
Përmes tij i dekni u ngjall, kur u pre me nijet kurbanit.

Ngjinimi osht kurban i jonë, ama osht jetë e shpirtit tonë,
Krejt trupin ta bojmë kurban, mysafir tash e kem xhanin.

Sabri osht një re e ambël, sa urtsia rigon ndër ne,
Se bash n'kët mujë t'bekumë, erdhen fjalët e Kuranit.

Kur nefsi osht n'zor e n'siklet, shpirti shkon drejt e n'Miraxh,
Kur dera e burgut prishet, xhani mrrin n'prani t'Xhananit.

Perden e territ zemra e shqeu, e me krah shkoi për havaje,
Ajo zemër prej melekve erdh e ja mrrini zamanit.

Kape shpejt konopin prej ktij bunari të trupit,
N'krye bunarit thirr me za: 'Erdh Jusufi i Kananit!'

Kur Isaja u liru prej gomari, ton duatë ju bon kabull,
Laji durt se prej qilles erdh, myzhde, sofra prej Xhananit.

Laji durt edhe gojen, as mos ha as me gojë mos b'zaj,
Lype at fjalë, at kafshatë, që ju erdh t'heshtunve t'Ramazanit.

Gazeli 892 nga Divani i Shemsi Tebrizit



**KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË
ORGANIZON FUSHATËN**

Dhuro një iftar!

**IFTARI PËR 1 PERSON
1500 lekë, 15€ ose 15\$**

NR. 110000709

Banka Kombëtare Tregtare

SWIFT CODE: NCBAALTXXX

BENEFICIARY NAME

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

IBAN ALL: AL 14 2051 1014 0007 09CL TJCL ALLO

IBAN USD: AL 85 2051 1014 0007 09CL TJCF USDA

IBAN EUR: AL 41 2051 1014 0007 09CL TJCF EURA